REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË**
**KËSHILLI BAHKIAK LIBOHOVË**

**Nr.831prot** **Libohovë më 06.05.2026**

**VENDIM**
**Nr. 17 datë, 30.04.2026**

# PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Bazuar në vendimin nr. 955, datë 07.12.2016" Për përcaktimin e kritereve , të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike" , në udhëzimin nr.5,datë 17.02.2017."Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 " Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike" Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH",VKB Libohovë, nr.3datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë" ,mbështetur në vlerësimin ekonomiko –social, propozojmë Këshillit Bashkiak për muajin Mars 2026 familjet që do të përfitojnë nga fondi 6%.

**VENDOSI**

**I.**Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i 6%, për familjet e mëposhtme,për muajin Mars 2026

| Nr | **Emri Atesia Mbiemri** | **Muaji** | **Shuma/lek** |
|---|---|---|---|
| 1 | Ferdi Sejfulla Ruli | Mars 2026 | 2178 |

**II.**Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndihmes Ekonomike.
**III.**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI I KËSHILLI**
**Rahim Skënderi**

**KRYETARI I KËSHILLIT**
**Asim Banushaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Miratuar me 13 (trermbëdhjetë) vota
Vota Pro : 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë

Adresa: Lagjia "Linua" Libohovë, email-bashkialibohove@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

**BASHKIA LIBOHOVË**
**SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE**

**Nr. 7/4 Prot** **Libohovë ,më 16.04.2026**

## PROJEKT- VENDIM
Nr 4 datë, 16/04/2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Bazuar në vendimin nr. 955, datë 07.12.2016" Për përcaktimin e kritereve , të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike" , në udhëzimin nr.5,datë 17.02.2017."Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 " Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike" Ligjin 57/2019"Për asistencën sociale në RSH",VKB Libohovë, nr.3datë 24.01.2025 "Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë" ,mbështetur në vlerësimin ekonomiko –social,
Ppropozojmë Këshillit Bashkiak ,për muajin mars 2026, familjet që do të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%.

| Nr | Emri Atesia Mbiemri | Muaji | Shuma/lek |
|---|---|---|---|
| 1 | Ferdi Sejfulla Ruli | MARS 2026 | 2178 |

Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndihmes Ekonomike.
Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

Sektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika

**KRYETARI**
**Leonard HIDE**

**Juristi**
Kristaq Ciko

**Prefektura Gjirokaster**
**Bashkia Libohove,Libohove**

# LISTË

## "LISTA E FAMILJEVE/INDIVIDËVE NË NEVOJË TË REKOMANDUAR PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% PËR PERIUDHËN Mars/2026

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Njësinë Administrative Libohove,Libohove rekomandon listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë për trajtim me fondin 6%.

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera konkludojmë se:

-Janë rekomanduar për trajtim me fondin 6% 1 familje, lista bashkëlidhur.

**Prefektura Gjirokaster**
**Bashkia Libohove,Libohove**
**Personi përgjegjës për ndihmën ekonomike**
**Emri, Mbiemri firma**
**MAJLINDA GJIKA**

Lista e plotë e familjeve të rekomanduara për trajtim me fondin 6% për periudhën e akorduar.

| Nr. | Emri Atësia Mbiemri | Fondi 6%(Vlera) | Kompensimi i Energjisë(Vlera) | Statusi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ferdi Sejfulla Ruli | 2178.00 | - | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË**
**KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

**Nr.** 832 **prot** **Libohovë më** 06 **.05.2026**

# VENDIM

**Nr. 18 Datë 30.04.2026**

## PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I VETË BASHKISË PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016 datë 21.04.2016 , në pikën 7 të Kreut II të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"Ligjin 57/2019"Për asistencën sociale në RSH",VKB Libohovë, nr.03 datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë" në bazë të propozimit të paraqitur nga zyra e Ndihmës Ekonomike ,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë , familjet në nevojë që kane dale jo fitues nga skema e ndihmës ekonomike, ose që nuk mund të aplikojnë, të perfitojne nga fondet e vete Bashkisë .

## VENDOSI

**I.**Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i akorduar nga Bashkia, për familjet e mëposhtme,për muajin Mars 2026

| | Emer,mbiemer | Arsyet | LEKE |
|---|---|---|---|
| 1 | Josif Proko | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 2 | Marika Mino | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 3 | Vilson Buzo | Prind i vetëm me 3 fëmijë të mitur | 5000 |
| 4 | Ferdi Ruli | Person i vetëm ,I paaftë për punë | 3000 |
| 5 | Gjergji Ruli | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 6 | Fredi Proko | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 7 | Zenel Çobani | Kryefamiljar në nevojë | 5000 |
| 8 | Enkeleda Matushi | Prind i vetëm me fëmijë të mitur | 5000 |

Adresa: Lagjia "Linua" Libohovë, email bashkialibohove@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

| | | | |
|---|---|---|---|
| 9 | Madrit Avduli | Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur | 5000 |
| 10 | Resul Sinani | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 11 | Shqiponjë Myftaraj | Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur | 5000 |
| 12 | Afërdita Mërtiri | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 13 | Rigels Ruli | Kryefamiljar ne nevojë | 5000 |
| 14 | Niko Karavidha | Person i paaftë për punë | 5000 |
| 15 | Vladimir Zeneli | Kryefamiljar ne nevojë | |
| 16 | Gani Ruçi | Prind i vetëm me 1 fëmijë të mitur | 5000 |

**II.**Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndihmes Ekonomike.
**III.**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Rahim Skënderi**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Asim Banushaj**

Miratuar me 13 (trermbëdhjetë) vota
Vota Pro : 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË**

**SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE**

Nr. 704 Prot. Libohovë më 16.04.2026

**PROJEKT-VENDIM**

Nr 03 datë 16/04/2026

PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I VETË BASHKISË PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016 datë 21.04.2016 , në pikën 7 të Kreut II të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"Ligjin 57/2019"Për asistencën sociale në RSH",VKB Libohovë, nr.3 datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë" në bazë të propozimit të paraqitur nga zyra e Ndihmës Ekonomike ,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë , familjet në nevojë që kane dale jo fitues nga skema e ndihmës ekonomike, të perfitojnë ndihmë (në lekë) nga fondet e Pushtetit Lokal :

Propozojmë Këshillit Bashkiak.

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i akorduar nga bashkia familjet e mëposhtme,për muajin MARS 2026.

| | Emer,mbiemer | Arsyet | LEKE |
|---|---|---|---|
| 1 | Josif Proko | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 2 | Marika Mino | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 3 | Vilson Buzo | Prind i vetëm me 3 fëmijë të mitur | 5000 |
| 4 | Ferdi Ruli | Person i vetëm ,I paaftë për punë | 3000 |
| 5 | Gjergji Ruli | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 6 | Fredi Proko | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 7 | Zenel Çobani | Kryefamiljar ne nevojë | 5000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 8 | Enkeleda Matushi | Prind i vetëm me fëmijë të mitur | 5000 |
| 9 | Madrit Avduli | Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur | 5000 |
| 10 | Resul Sinani | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 11 | Shqiponjë Myftaraj | Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur | 5000 |
| 12 | Afërdita Mërtiri | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 13 | Rigels Ruli | Kryefamiljar ne nevojë | 5000 |
| 14 | Niko Karavidha | Person i paaftë për punë | 5000 |
| 15 | Vladimir Zeneli | Kryefamiljar ne nevojë | 5000 |
| 16 | Gani Ruçi | Prind i vetëm me 1 fëmijë të mitur | 5000 |

Luten anëtarët e Këshillit Bashkiak të miratojnë ose jo dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin mars 2026.

Sektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika

**KRYETARI**
**Leonard HIDE**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

**Juristi**
Kristaq Ciko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË**
**KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

**Nr.** 833 **prot** **Libohovë më** 06**.05.2026**

**VENDIM**

**Nr. 19 Datë 30.04.2026**

**PËR MIRATIMIN E VLERËSIMIT MONETAR TË BANESAVE TË DËMTUARA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ZAGORI**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr. 107, datë 22.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile",VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" kreu III, pika 1, gërma ë, dhe kreu III, pika 3, gërma ç,

**VENDOSI :**

**I.**Të miratohet dokumentacioni teknik dhe financiar për 7 banesat e dëmtuara në Njësinë Administrative Zagori.

**II.**Miratohet vlera totale e dëmit për të 7 banesat në vlerën: **47.364,125 lekë.**

**III.** Të kërkohet mbështetje financiare në përputhje me nenin 41, pika 4 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" e cila parashikon **"Në rast se vlera e kompesimit tejkalon 30% të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendos kompesimin të kryhet nga AKMC-ja"**

**IV.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni I Emergjencave Civile.

**V.**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Rahim Skënderi**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Asim Banushaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Adresa: Lagjia "Lizua" Libohovë, email-bashkialibohove@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

Miratuar me 13 (trermbëdhjetë) vota
Vota Pro : 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË

KOMISIONI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 790 Prot. Libohovë, më 29.04.2026

# RELACION

## PËR MIRATIMIN E VLERËSIMIT MONETAR TË BANESAVE TË DËMTUARA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ZAGORI

## KËSHILLIT BASHKIAK LIBOHOVË

I nderuar Kryetar i Këshillit!

Të nderuar këshilltarë dhe pjesmarrës në këtë mbledhje!

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; legjislacionin në fuqi për trajtimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore; si dhe Vendimin Nr. 89, datë 03.02.2016 të Entit Kombëtar të Banesave për çmimet reference, paraqesim këtë relacion si më poshtë vijon:

Siç është e njohur, në muajin janar qarku Gjirokastër u prek nga kushte tepër të rëndura armosferike, të cilat shkaktuan pasoja të përmasave të mëdha edhe në disa banesa të Njësisë Administrative Zagori, Bashkia Libohovë. Më konkretisht, në Njësinë Administrative Zagori janë evidentuar **7 (shtatë) banesa të dëmtuara**: **3 në fshatin Zhej**, **2 në fshatin Konckë** dhe **2 në fshatin Hoshtevë**. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së këtyre banesave Bashkia Libohovë ka kërkuar në rrugë institucionale mbështetjen e Institutit të Ndërtimit, i cili nëpërmjet Akt ekspertizës me nr.275/5 Prot., datë 26.03.2026 ka dalë në konkuzionet e mëposhtme: " *Nga inspektimi në terren i objekteve të banimit të ndodhura në fshatrat Hoshtevë, Konckë dhe Zhej në Zagori, Libohovë; si dhe nga analiza vizuale e dëmtimeve të evidentuara në elementet konstruktive, rezulton se objektet kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme strukturore. Dëmtimet e konstatuara në muret mbajtëse, në elementet e muraturës dhe në pjesë të ndryshme të strukturës janë pasojë e lëvizjeve të terrenit dhe rrëshqitjeve të dheut, të ndikuara nga reshjet e vazhdueshme dhe nga karakteristikat gjeologjike të terrenit. Çarjet e theksuara në muraturën mbajtëse, deformimet e konstatuara në strukturë dhe zhvendosjet e mundshme të themeleve tregojnë se qëndrueshmëria strukturore e objekteve është dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme.*"

Adresa: Rruga "Avni Rustemi", Lagjia "Linua", Libohovë, Tel :0035588122091, bashkialibohovë@outlook.com

Lidhur me sa më lart, nga ana e ekspertëve të Institutit të Ndërtimit janë lënë këto rekomandime:

**"Duke u bazuar në gjendjen aktuale të objekteve të inspektuara në fshatrat Hoshtevë, Konckë dhe Zhej, në Zagori Libohovë, si dhe duke marrë në konsideratë dëmtimet e theksuara strukturore dhe paqëndrueshmërinë e terrenit, rekomandohen këto masa:**

- **Të merren masa për ndalimin e përdorimit dhe evakuimin e plotë të objekteve, në mënyrë që të shmanget çdo rrezik i mundshëm për jetën dhe shëndetin e banorëve.**
- **Të vendosen masa sigurie dhe sinjalistikë paralajmëruese në zonën përreth objekteve për të kufizuar hyrjen dhe përdorimin e tyre.**
- **Duke qenë se objektet nuk paraqesin mundësi reale për përforcim apo rehabilitim strukturor, rekomandohet që të vlerësohet mundësia e shembjes së tyre në mënyrë të kontrolluar, për të eliminuar rrezikun që ato paraqesin.**
- **Për çdo zhvillim të ardhshëm në këto zona rekomandohet kryerja e një studimi të detajuar gjeologjik të terrenit, me qëllim përcaktimin e stabilitetit të tokës dhe të kushteve të përshtatshme për ndërtim."**

Bazuar në rekomandimet e mësipërme të Institutit të Ndërtimit, të cilat theksojnë faktin se, objektet janë të pabanueshme, paraqesin rrezik për jetën dhe duhet të prishen është kryer vlerësim financiar për secilën banesë, me qëllim vijimin e procedurave të dëmshpërblimit financiar, në përputhje me nenin 41, pika 2 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" e cila parashikon: "Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile", ndërkohë që pika 4 e po këtij neni parashikon "**Në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendos që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja**". Vlerësimi teknik dhe ekonomik është kryer nga ekspertë të licencuar, bazuar në çmimet referencë të VKM nr. 89/2016, sipërfaqet përkatëse dhe gjendjen faktike. Duke qenë se objektet janë me humbje të plotë funksionale, vlerësimi është bërë pa amortizim sipas tabelës më poshtë:

| **Nr** | **Emri i përfituesit** | **Fshati** | **Vlera (lekë)** |
|---|---|---|---|
| 1 | Fredi Qirjako Proko | Konckë | 4,930,245 |
| 2 | Spiro Nikolla Nika | Konckë | 6,941,500 |
| 3 | Koço Stathi Puleshi | Hoshtevë | 9,688,580 |
| 4 | Vasil Perikli Hila | Hoshtevë | 9,394,250 |
| 5 | Marika Koço Mino | Zhej | 4,488,750 |
| 6 | Filip Vasil Mekshi | Zhej | 9,884,800 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 7 | Garito Shaka | Zhej | 2,036,000 |

**Totali i përgjithshëm: 47,364,125 lekë**

Referuar sa më lart, propozojmë miratimin e një vendimi nga Këshilli Bashkiak për trajtimin e kësaj situate emergjente dhe mbështetjen e familjeve të prekura për banesat e dëmtuara.

**KOMISIONI I EMERGJENCAVE CIVILE**

| Kryetar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|
| Xhelil Tusuni | Gazmend Çulla | Llazar Meksi |

Adresa: Rruga "Avni Rustemi", Lagjia "Linua", Libohovë, Tel :0035588122091, bashkialibohovë@outlook.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË**

**KOMISIONI I EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. ________Prot                                                    Libohovë, më ____.____.2026

**PROJEKT-VENDIM**

**NR _____, DATË ________________**

**PËR MIRATIMIN E VLERËSIMIT MONETAR TË BANESAVE TË DËMTUARA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ZAGORI**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr. 107, datë 22.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile",VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" kreu III, pika 1, gërma ë, dhe kreu III, pika 3, gërma ç,

**VENDOSI:**

1. Të miratohet dokumentacioni teknik dhe financiar për 7 banesat e dëmtuara në Njësinë Administrative Zagori.
2. Të miratohet vlera totale e dëmit për të 7 banesat në vlerën: **47,364,125 lekë**.
3. Të kërkohet mbështetje financiare në përputhje me nenin 41, pika 4 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" e cila parashikon **"Në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendos që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja".**
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

| **Nënkryetari** | **KRYETARI** | **Juristi** |
|---|---|---|
| **Xhelil Tusuni** | **Leonard Hide** | **Kristaq Çiko** |

Adresa: Rruga "Avni Rustemi", Lagjia "Linua", Libohovë, Tel :0035588122091, bashkialibohovë@outlook.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË**
**KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

**Nr.** 834 **prot** | **Libohovë më** 06 **.05.2026**

**VENDIM**

**Nr. 20 Datë 30.04.2026**

**PËR**
**MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL TË STREHIMIT 2026–2031, BASHKIA LIBOHOVË**

Në mbështetje të nenit 55 dhe 56 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Libohovë, Këshilli Bashkiak Libohovë,

**V E N D O S I:**

**I.** Të miratojë "Planin Social të Strehimit 2026–2030, Bashkia Libohovë", sipas dokumentit bashkëlidhur, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**II.** Plani Social i Strehimit synon:

- Përmirësimin e kushteve të strehimit për familjet në nevojë.
- Mbështetjen e grupeve vulnerabël përmes programeve të strehimit social.
- Zhvillimin e banesave sociale dhe subvencionimin e qirasë.
- Rritjen e aksesit në programe financimi për strehim.
- Përmirësimin e menaxhimit dhe monitorimit të politikave të strehimit në nivel vendor.

**III.** Ngarkohet Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, në bashkëpunim me sektorët përkatës në Bashkinë Libohovë, për zbatimin, monitorimin dhe raportimin periodik të këtij plani.

**IV.** Ngarkohet Sektori Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për planifikimin e fondeve në buxhetin vjetor, në funksion të zbatimit të Planit Social të Strehimit 2026–2031.

**V.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

Adresa: Lagjia "Vrinua" Libohovë, email-bashkialibohove@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Rahim Skënderi**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Asim Banushaj**

Miratuar me 13 (trermbëdhjetë) vota
Vota Pro : 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË

Nr. 494 Prot.

Libohovë, më 29.04.2026

# RELACION

## PËR
## MIRATIMIN E PROGRAMIT 5-VJEÇAR TË STREHIMIT SOCIAL 2026–2031 NË BASHKINË LIBOHOVË

### I. Qëllimi i relacionit

Ky relacion paraqitet përpara Këshillit Bashkiak Libohovë me qëllim miratimin e Programit 5 -vjeçar të Strehimit Social 2026–2031, i cili synon përmirësimin e kushteve të strehimit për qytetarët, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet në pozita të pafavorizuara.

### II. Kuadri ligjor

Mbeshtetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshur, neni 24 dhe neni 54, shkronja "k", si edhe në nenin 68 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", i cili përcakton se strukturat përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore hartojnë programe shumëvjeçare të strehimit social për popullsinë nën juridiksionin e tyre, në përputhje me analizën e nevojave dhe strategjitë kombëtare. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashkinë Libohovë, në bashkëpunim me Grupin e Punës, ka hartuar Programin 5 -vjeçar të Strehimit Social 2026–2031.

### III. Gjendja aktuale dhe nevoja për ndërhyrje

Nga analiza e situatës në Bashkinë Libohovë rezulton se:

- Ekziston një numër familjesh me kushte të papërshtatshme strehimi.
- Ka kërkesa në rritje për përfitim nga programet e strehimit social.
- Evidentohet mungesë e stokut të banesave sociale.
- Ka nevojë për ndërhyrje në rikonstruksionin dhe përmirësimin e banesave ekzistuese.
- Kapacitetet financiare dhe teknike të bashkisë janë të kufizuara dhe kërkojnë planifikim të mirëfilltë.
- Këto kushte bëjnë të domosdoshëm hartimin e një programi të strukturuar dhe të qëndrueshëm.

## IV. Parimet mbi të cilat mbështetet programi

Programi mbështetet në parimet e përcaktuara në ligjin për strehimin social, si:

- Parimi i strehimit të përballueshëm.
- Parimi i strehimit të përshtatshëm.
- Parimi i transparencës dhe informimit.
- Parimi i sigurisë së qëndrimit.
- Gjithashtu, programi fokusohet tek familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet vulnerabël, sipas përcaktimeve ligjore.

## V. Analiza dhe përmbajtja e programit

Grupi i punës ka realizuar një vlerësim të thelluar të situatës ekzistuese, i cili përfshin:

- Analizën e kontekstit lokal, përfshirë trendet demografike dhe socio-ekonomike;
- Analizën e kapaciteteve financiare dhe teknike të bashkisë;
- Analizën e grupeve vulnerabël dhe të margjinalizuara;
- Analizën e nevojave për strehim social dhe të përballueshëm;
- Analizën e tokës potenciale për zhvillim të strehimit social;
- Identifikimin e programeve të mundshme të strehimit që mund të aplikohen.
- Programi përmban gjithashtu vizionin, objektivat dhe aktivitetet konkrete për zbatimin e tij.

## VI. Objektivat dhe ndërhyrjet kryesore

Nëpërmjet këtij programi, Bashkia Libohovë synon:

- Përmirësimin e kushteve të jetesës për familjet në nevojë;
- Rritjen e aksesit në programet e strehimit social;
- Diversifikimin e instrumenteve dhe skemave të strehimit;
- Mbështetjen e grupeve vulnerabël;
- Përmirësimin e administrimit të sektorit të strehimit.
- Ndërhyrjet kryesore përfshijnë:
- Subvencionimin e qirasë;
- Përmirësimin dhe rikonstruksionin e banesave;
- Zhvillimin e banesave sociale;
- Aplikimin e instrumenteve të reja financiare dhe bashkëpunimin me partnerë.

## VII. Aspektet financiare

Programi është hartuar në përputhje me kapacitetet financiare dhe teknike të bashkisë dhe parashikon financim nga:

- Buxheti i Bashkisë Libohovë.
- Fondet nga buxheti i shtetit.

- Programe kombëtare për strehimin social.
- Donatorë dhe partnerë zhvillimi.
- Propozimet konkrete dhe vlerësimet e kostove janë të detajuara në dokumentin bashkëlidhur.

## VIII. Përfitimet e pritshme

Zbatimi i këtij programi pritet të sjellë.

- Përmirësim të kushteve të strehimit për familjet në nevojë.
- Ulje të përjashtimit social.
- Rritje të mirëqenies dhe stabilitetit social.
- Zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit.

## IX. Përfundime

Programi 5 -vjeçar i Strehimit Social 2026–2031 është një dokument i rëndësishëm strategjik që adreson në mënyrë të integruar nevojat për strehim në Bashkinë Libohovë, duke propozuar zgjidhje konkrete dhe të zbatueshme. Analiza, objektivat dhe programet e detajuara paraqiten në dokumentin bashkëlidhur.

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak Libohovë miratimin e Programit 5-vjeçar të Strehimit Social 2026–2031.

**Jurist**

**Kristaq Ciko**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Leonard Hide**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

Nr.______ Prot. Libohovë, më ___.___.2026

**PROJEKT– VENDIM**
**Nr. ______, datë ___.___.2026**

**PËR**
**MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL TË STREHIMIT 2026–2031, BASHKIA LIBOHOVË**

Në mbështetje të nenit 55 dhe 56 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Libohovë, Këshilli Bashkiak Libohovë,

**V E N D O S I:**

I. Të miratojë "Planin Social të Strehimit 2026–2030, Bashkia Libohovë", sipas dokumentit bashkëlidhur, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

II. Plani Social i Strehimit synon:

- Përmirësimin e kushteve të strehimit për familjet në nevojë.
- Mbështetjen e grupeve vulnerabël përmes programeve të strehimit social.
- Zhvillimin e banesave sociale dhe subvencionimin e qirasë.
- Rritjen e aksesit në programe financimi për strehim.
- Përmirësimin e menaxhimit dhe monitorimit të politikave të strehimit në nivel vendor.

III. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, në bashkëpunim me sektorët përkatës në Bashkinë Libohovë, për zbatimin, monitorimin dhe raportimin periodik të këtij plani.

IV. Ngarkohet Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për planifikimin e fondeve në buxhetin vjetor, në funksion të zbatimit të Planit Social të Strehimit 2026–2031

V. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër

| **NËNKRYETARI** | **KRYETARI** | **JURISTI** |
|---|---|---|
| **Xhelil Tusuni** | **Leonard Hide** | **Kristaq Ciko** |









# PLANI SOCIAL I STREHIMIT
# BASHKIA LIBOHOVË

www.bashkialibohove.gov.al

**Miratoi:**

**KRYETAR I BASHKISË**

**Leonard Hide**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA LIBOHOVE

Nr. 794 Prot.

Datë 29.04.2026

Ky dokument është hartuar nga Bashkia Libohovë në kuadër të procesit të përgatitjes së Planit Social të Strehimit, në përputhje me Ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social" dhe aktet nënligjore përkatëse, të cilat përcaktojnë detyrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për hartimin e programeve lokale 5-vjeçare të strehimit (Plane Vendore të Strehimit Social). Dokumenti është përgatitur nga stafi teknik dhe administrativ i Bashkisë Libohovë dhe synon të analizojë situatën e strehimit në territorin e bashkisë, të identifikojë nevojat dhe grupet në nevojë për strehim, si dhe të përcaktojë objektivat dhe masat prioritare për periudhën planifikuese pesëvjeçare.

**Grupi i Punës – Bashkia Libohovë**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Majlinda Gjika | - Kryetar | Specialist Strehimi dhe Kujdesi Social |
| 2. Ana Xhaferi | - Anëtar | Ekspert i Hartimit të Dokumentacionit |
| 3. Xhelil Tusuni | - Anëtar | Specialist i Çështjeve Sociale |
| 4. Nelson Sejdo | - Anëtar | Ekspert Planifikimi Urban dhe GIZ/Arkitekt |
| 5. Kristaq Ciko | - Anëtar | Specialist i Çështjeve Ligjore Administrative |
| 6. Joana Muci | - Anëtar | Specialist Finance |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

## Tabela e Përmbajtjes


1. Hyrje ........ 5
   1.1 Qëllimi i planit ........ 5
   1.2 Metodologjia e përdorur ........ 6
   1.3 Struktura e dokumentit ........ 7
   1.4 Profili i Bashkisë ........ 7
   1.5 Dokumenta strategjike ne nivel kombetar dhe vendor ........ 10
2. Vlerësim i thelluar i situatës ekzistuese ........ 11
   2.1 Analizë e trendeve demografike e social-ekonomike të popullsisë ........ 11
   2.2 Analiza e zhvillimit ekonomik dhe aspektet financiare ........ 12
      2.2.1 Situata financiare e bashkisë ........ 12
      2.2.2 Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik ........ 14
   2.3 Analiza e Grupeve Vulnerabël ........ 15
      2.3.1 Personat me aftësi të kufizuar dhe invalidë ........ 15
   2.4 Analiza e tregut te banesave ........ 17
   2.5 Analiza e nevojave për Strehim Social dhe të përballueshëm ........ 19
      2.5.1 Zbatimi i programit të banesave sociale me qira ........ 28
      2.5.2 Programi i Banesave me Kosto të Ulët ........ 28
      2.5.3 Programi për Përmirësmin e Kushteve të Banesave Ekzituese, deri në ndërtim të ri ........ 28
      2.5.4 Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin ........ 28
      2.5.5 Strehet e përkohshme ........ 28
   2.6 Analiza e trojeve potenciale per ndertim per qellime strehimi social ........ 28
3. Vizioni, Objektivat dhe Programet ........ 30
   3.1 Vizioni dhe sfidat kryesore të bashkisë ........ 30
   3.2 Qëllimet dhe parimet ........ 30
   3.3 Programet e propozuara (Objektivat afatgjata) ........ 31
   3.4 Programi i detajuar ........ 33
4. Monitorimi dhe Zbatimi ........ 39
   4.1 Treguesit për monitorimin e zbatimit të vetë strategjisë ........ 39
   4.2 Risqet e zbatimit ........ 14
5. Referencat ........ 47


REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Lista e tabelave

Tabela 1. Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike sipas Njësive Administrative ................ 8
Tabela 2. Popullsia sipas grupmoshave .......................................................................................... 8
Tabela 3. Popullsia dhe raporti gjinor për çdo njësi administrative në Bashkinë Libohovë ................. 11
Tabela 4. Koeficientët e varësisë moshore.......................................................................................... 11
Tabela 5. Shtesa natyrore për Bashkinë Libohovë 2017-2020.............................................................. 12
Tabela 6. Të ardhurat e Bashkisë Libohovë.......................................................................................... 12
Tabela 7. Shpenzimet e Bashkisë Libohovë .......................................................................................... 13
Tabela 8. Të ardhurat e Bashkisë Libohovë.......................................................................................... 14
Tabela 9. Ndërrmarrje aktive në Libohovë .......................................................................................... 15
Tabela 10. Punësimi sipas degëve të ekonomisë në secilën nga Njësitë Administrative ...................... 15
Tabela 11. Numri i personave me PAK dhe Invalidë Pune.................................................................... 15
Tabela 12. Numri i banesave sipas qëllimit të përdorimit.................................................................... 17
Tabela 13. Mosha e ndërtesave për qëllime banimi në Bashkinë Libohovë ......................................... 17
Tabela 14. Ndërtesat sipas tipologjisë................................................................................................ 17
Tabela 15. Kostoja e ndërtimit............................................................................................................ 18
Tabela 16.Fondet e alokuara nga Qeveria Qendrore në Bashkinë Libohovë për programet e strehimit 27
Tabela 17. Programi i detajuar............................................................................................................ 3
Tabela 18. Monitorimi i situatës së strehimit në Bashki ....................................................................... 9
Tabela 19. Monitorimi i zbatimit të strategjisë .................................................................................... 10
Tabela 20. Risqet dhe masat për minimizimin e tyre........................................................................... 14

Lista e Grafikëve

Grafiku 1. Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike ....................................................... 8
Grafiku 2. Përqindja sipas grupmoshave ............................................................................................. 9
Grafiku 3. Shpërndarja e banorëve sipas gjinisë për çdo Njësi Administrative të Bashkisë Libohovë dhe raporti gjinor ..................................................................................................................... 11
Grafiku 4. Popullsia sipas grupmoshës dhe Njësive Administrative...................................................... 11
Grafiku 5. Koefiçienti i varësisë moshore tek të rinjtë dhe të moshuarit ............................................. 11
Grafiku 6. Natyra ekonomike e Shpenzimeve ..................................................................................... 13
Grafiku 7. Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja.............................................. 16
Grafiku 8. Ndërtesat sipas vitit të ndërtimit dhe Njësive Administrative.............................................. 17

Lista e Figurave

Figura 1: Ndarja Administrative e Bashkisë Libohovë.......................................................................... 7
Figura 2. Fakte të shpejta..................................................................................................................... 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

# 1. Hyrje

Agjenda 2030 Për Zhvillimin e Qëndrueshëm e OKB, pranuar dhe përshtatur nga të gjitha vendet anëtare të OKB në 2015, ofron një perspektivë të qartë për zhvillimin e qëndrueshëm. Shqipëria, si një ndër vendet anëtare të OKB-së, ka marrë angazhime konkrete në zbatimin e agjendës, e cila përbëhet nga 17 qëllime strategjike. Një ndër qëllimet kryesore, përkatësisht Qëllimi 11 për krijimin e Qyteteve dhe Vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të sigurta, resiliente (të afta për t'u ripërtërirë) dhe të qëndrueshme lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin urban dhe me strehimin social (SDG). Në kuadër të këtij objektivi synohet që deri në 2030 të sigurohet për të gjithë qasje në strehim të përshtatshëm, të sigurtë dhe të përballueshëm si dhe në shërbime bazë dhe përmirësimin e vendbanimeve me kushte të papërshtatshme. Një element thelbësor në objektivat e SDG 11 është dhe ndërlidhja dhe integrimi i politikave të ndryshme të zhvillimit urban me çështjet e strehimit, reduktimin e riskut të fatkeqësive dhe me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Ligji Nr. 22/2018 'Për strehimin social' përfaqëson një kapërcim të qenësishëm cilësor në mënyrën si perceptohet strehimi i përballueshëm, si adresohen grupet në nevojë, dhe si hartohen programet e veçanta tëstrehimit. Bashkitë vendosen në pozicion proaktiv në lidhje me ofrimin e strehimit social, dhe luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në identifkimin dhe hartëzimin e grupeve në nevojë, si dhe në identifkimin e mënyrave të fnancimit për strehimin e nevojshëm.

Hartimi i programeve 5-vjeçare të strehimit në bashki realizon prioritarizimin dhe buxhetimin e objektivave lokale të strehimit social për periudhën afatmesme. Hartimi i këtyre programeve shërben si parakusht për bashkitë që të përftojnë mbështetje nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për ndërtim të banesave sociale me qira dhe atyre me kosto të ulët.

Papërballueshmëria e tregut të banesave është gjithnjë në rritje, ashtu sikurse nevojat për strehim janë të larmishme për kategori të ndryshme. Këto sfida duhen adresuar në mënyrë të dedikuar nga niveli vendor, bazuar në faktorët specifk të territorit të tyre. Në këtë kuadër, një ndër detyrat kryesore të Bashkisë Libohovë për sektorin e strehimit është hartimi i programit 5-vjeçar të strehimit social në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Hartimi i këtij programi shërben si kusht kryesor për përfitimin e fondeve nga Qeveria Qendrore në lidhje me gjashtë programet aktualisht të përcaktuara në ligjin për strehimin social. Plani ndihmon për të kuptuar procesin e diagnozës dhe prioritarizimit të ndërhyrjeve e programeve që duhet të bëjë bashkia për të përmirësuar situatën e strehimit të përballueshëm në territory, si dhe i mundëson bashkisë identifikimin e nevojave specifike për strehim social dhe planifikimin buxhetor për to.

## 1.1 Qëllimi i Planit

Sipas ligjit nr. 22/2018, 'Për Strehimin Social', neni 68, programi lokal 5-vjeçar i strehimit duhet të përmbajë:

a) Burimet e financimit, që përfshijnë fonde nga buxheti i shtetit, fondet e siguruara nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe fonde nga burime të tjera, duke përcaktuar origjinën e tyre;

b) Nevojat për strehim, sipas parashikimeve të këtij ligji, duke përcaktuar grupet e familjeve sipas të ardhurave dhe gjendjes së tyre sociale;

c)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Lidhjet e këtij programi me programe të tjera të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe mënyrën e ndikimit të tyre te njëra-tjetra;

ç) Masën e rritjes së fondit publik të banesave, brenda një viti financiar, me ndërtesa që do të jepen me qira, uzufrukt ose huapërdorje, si dhe numrin dhe kategoritë e familjeve që do të përfitojnë banesa sociale me qira, uzufrukt ose huapërdorje;

d) Numrin e familjeve që do të përfitojnë banesa me kosto të ulët dhe mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;

dh) masën e subvencionimeve nga buxheti i shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në ndihmë të përfituesve për shlyerjen e qirave ose interesave të kredive me kushte lehtësuese;

e) numrin dhe sipërfaqet e trojeve të pajisura me plan zhvillimi, infrastrukturë për ndërtim banesash, numrin dhe llojin e banesave që do të ndërtohen, familjet që do të përfitojnë, formën e bashkëpunimit me sektorin privat, si dhe masën e përqindjen e kontribuesve;

ë) Numrin e strehëve të përkohshme dhe të banesave të specializuara që do të ndërtohen ose do të vihen në dispozicion të përfituesve;

f) Numrin e banesave ekzistuese ose të reja, që do të përfitojnë nga programi i granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit;

g) Numrin e banesave që do të përfitohen si rezultat i zbatimit të programit për zhvillimin e zonave me qëllim strehimin, për banesa sociale;

gj) numrin, vendndodhjen dhe profilin e familjeve që jetojnë në banesa që nuk mund të legalizohen dhe që preken nga investime publike ose private, sipas planeve rregulluese".

Ky plan ka si qëllim njohjen dhe identifikimin e grupeve vulnerabël dhe nevoja e tyre për strehim, dhe propozimi i alternativave afatmesme për sigurimin e strehimit të përballueshëm, sipas programeve të legjislacionit përkatës.

Qëllimi i planit detajohet si më poshtë:

(i) Vlerësimi i kontekstit dhe nevojave për strehimi social për grupet sipas ligjit dhe veçanërisht ato më të cenuara në territorin e bashkisë;

(ii) Vlerësim i kapaciteteve në nivel bashkie qofshin ato njerëzore, teknike, financiare dhe organizative për të adresuar shërbime/nevoja të tilla;
Propozime konkrete dhe vlerësime të buxhetit për zbatimin e tyre, sipas nevojave për strehim dhe instrumenteve ligjore e financiare. Masën e rritjes së fondit publik të banesave, brenda një viti financiar, me ndërtesa që do të jepen me qira, uzufrukt ose huapërdorje, si dhe numrin dhe kategoritë e familjeve që do të përfitojnë banesa sociale me qira, uzufrukt ose huapërdorje;

h) Numrin e familjeve që do të përfitojnë banesa me kosto të ulët dhe mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;

dh) masën e subvencionimeve nga buxheti i shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në ndihmë të përfituesve për shlyerjen e qirave ose interesave të kredive me kushte lehtësuese;

i) numrin dhe sipërfaqet e trojeve të pajisura me plan zhvillimi, infrastrukturë për ndërtim banesash, numrin dhe llojin e banesave që do të ndërtohen, familjet që do të përfitojnë, formën e bashkëpunimit me sektorin privat, si dhe masën e përqindjen e kontribuesve;

ë) Numrin e strehëve të përkohshme dhe të banesave të specializuara që do të ndërtohen ose do të vihen në dispozicion të përfituesve;

j) Numrin e banesave ekzistuese ose të reja, që do të përfitojnë nga programi i granteve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit;

k) Numrin e banesave që do të përfitohen si rezultat i zbatimit të programit për zhvillimin e zonave me qëllim strehimin, për banesa sociale;

gj) numrin, vendndodhjen dhe profilin e familjeve që jetojnë në banesa që nuk mund të legalizohen dhe që preken nga investime publike ose private, sipas planeve rregulluese".

Ky plan ka si qëllim njohjen dhe identifikimin e grupeve vulnerabël dhe nevoja e tyre për strehim, dhe propozimi i alternativave afatmesme për sigurimin e strehimit të përballueshëm, sipas programeve të legjislacionit përkatës.

Qëllimi i planit detajohet si më poshtë:

(i) Vlerësimi i kontekstit dhe nevojave për strehimi social për grupet sipas ligjit dhe veçanërisht ato më të cenuara në territorin e bashkisë;

(ii) Vlerësim i kapaciteteve në nivel bashkie qofshin ato njerëzore, teknike, financiare dhe organizative për të adresuar shërbime/nevoja të tilla;

(iii) Propozime konkrete dhe vlerësime të buxhetit për zbatimin e tyre, sipas nevojave për strehim dhe instrumenteve ligjore e financiare.

## 1.2 Metodologjia e Përdorur

Hartimi i një Programi 5-Vjeçar Strehimi është një proces kompleks, i cili përfshin disa hapa të rëndesishëm si rishikimi i dokumentave ekzistues, komunikimi me publikun, qoftë konsulta me grupet e interesit, apo intervista dhe vëzhgime për grupet në nevojë. Programi u hartua në bashkëpunim me drejtoritë si: Planifkimi dhe Zhvillimi i Territorit, Mbështetja dhe Mbrojtja Sociale, Emergjencat Civile, Fnancat dhe Buxheti, Mjedisi, Arsimi etj. Në këtë kuadër, fillimisht u organizua një takim, gjatë të cilit u përcaktua grupi i punës që do të ishte përgjegjës për hartimin e planit duke përfshirë ekspertiza nga sektorë të ndryshëm dhe në përbërjen e tij si:

1. Specialist Strehimi dhe Kujdesi Social
2. Ekspert i Hartimit të Dokumentacionit
3. Specialist i Çështjeve Sociale
4. Ekspert Planifikimi Urban dhe GIZ/Arkitekt
5. Ekspert i Çështjeve Ligjore Administrative
6. Specialist Finance

Një ndër detyrat e para të grupit të punës është kryerja e një vlerësimi paraprak dhe krijimi i një databaze me të dhënat ekzistuese të nevojshme për hartimin e programit. Në këtë rast, grupi i punës duhet të mbledhë të gjithë të dhënat e nevojshme nga drejtoritë të cilat mund të lidhen me grupet vulnerabël, financat e bashkisë, projekte të mëparshme në fushën e strehimit, riskun e fatkeqësive dhe implikimet në strehim, të dhëna për zonat informale, të dhëna nga planifkimi dhe zhvillimi i territorit etj. nëpërmjet pyetësoreve të dërguar strukturave përkatëse në bashki. Pas mbledhjes se të dhenave u realizua nje material "draft" i planit, i cili ishte gati per t'u prezantuar dhe rishikuar gjatë dëgjesave publike të parashikuara me palët e interesuara në nivel lokal. Gjatë këtyre dëgjesave u trajtuan çështjet e nevojshme dhe u morrën masat për reflektimin e komenteve/sugjerimeve në versionin final të planit Lokal për Bashkinë Libohovë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

## 1.3 Struktura e Dokumentit

Plani është strukturuar në 3 pjesë kryesore:

I. Përshkrimi i përgjithshëm mbi Bashkinë dhe të dhëna bazë;
II. Analiza të thelluara të situatës ekzistuese: tendenca demografike e social-ekonomike; grupet e cenuara (vulnerabël); tregu i banesave në Bashkinë Libohovë; nevojat për strehim social dhe të përballueshëm; troje potenciale për ndërtim për qëllime strehimin social në bashki; potenciale për aplikimin e instrumenteve financiare për zhvillimin e tokës, sipas legjislacionit për planifikimin e territorit dhe ligjit nr. 22/2018 'Për strehimin social'.
III. Paraqitja e Vizionit, Objektivave dhe Programeve/Projekteve që i përshtaten bashkisë si rezultat i analizave, përfshirë edhe udhëzime për monitorimin dhe zbatimin e planit.

## 1.4 Profili i Bashkisë

Bashkia Libohovë ndodhet në jug të Shqipërisë, në Qarkun e Gjirokastrës, dhe kufizohet në veri me Bashkinë Këlcyrë, në lindje me Bashkinë Përmet, në jug me Bashkinë Dropull dhe në perëndim me Bashkinë Gjirokastër. Kryeqendra administrative e bashkisë është qyteti i Libohovës, një qendër urbane me vlera të rëndësishme historike, arkitekturore dhe kulturore, e njohur për kalatë, shtëpitë monumentale dhe trashëgiminë e pasur kulturore.

Territori i Bashkisë Libohovë shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 248.24 km², duke përfshirë tre njësi administrative: Libohovë, Qendër dhe Zagori, si dhe një numër fshatrash me karakter rural dhe malor. Zona ka një reliev të larmishëm, me lugina bujqësore dhe zona kodrinore-malore, që krijojnë potencial për bujqësi, blegtori, turizëm kulturor dhe natyror. Sipas Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, popullsia rezidente e Bashkisë Libohovë rezulton 2,765 banorë, duke reflektuar një rënie të ndjeshme krahasuar me Censin e vitit 2011 dhe regjistrin civil, ku numri i banorëve ishte më i lartë për shkak të emigracionit të madh dhe lëvizjeve demografike. Në qytetin e Libohovës jetojnë rreth 1,599 banorë, ndërsa pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndarë në fshatrat dhe njësitë administrative përreth. Dendësia e popullsisë në territorin e bashkisë është relativisht e ulët, rreth 11.1 banorë për km², duke e karakterizuar Libohovën si një bashki me profil rural dhe me shpërndarje të rrallë të popullsisë. Struktura demografike tregon prirje të plakjes së popullsisë dhe migrimit të lartë, me shtesë natyrore negative dhe migrim neto negativ, çka përbën një sfidë për zhvillimin socio-ekonomik lokal. Ref: ëëë.qeverisjavendore.gov.al

Ekonomia lokale e Bashkisë Libohovë mbështetet kryesisht në bujqësi dhe blegtori, me aktivitete të konsiderueshme në kultivimin e produkteve bujqësore dhe bimëve medicinale, si dhe në sektorin e shërbimeve dhe agropërpunimit. Në territorin e bashkisë operojnë rreth 52 ndërmarrje aktive, ndërsa paga mesatare mujore për të punësuarit është rreth 59,553 lekë, duke reflektuar një ekonomi lokale me intensitet të ulët industrial dhe varësi nga sektorët tradicionalë. Ref: ëëë.qeverisjavendore.gov.al

Bashkia Libohovë ka një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit kulturor dhe natyror, falë trashëgimisë historike, monumenteve të kulturës, peizazheve natyrore dhe traditave lokale. Megjithatë, sfidat kryesore lidhen me rënien demografike, emigracionin, plakjen e popullsisë dhe nevojën për diversifikim ekonomik, investime në infrastrukturë, shërbime publike dhe krijimin e mundësive të reja për punësim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

*Figura 1: Ndarja Administrative e Bashkisë Libohovë*



*Figura 2. Fakte të shpejta*

Sipërfaqja: 248.24km2

Fshatr: 17

Qytete: 1

Banore: 6,844

Në krahasim me vitin 2021, numri i familjeve përfituese të NE në vitin 2023 është rritur nga 19 (në 2021) në 24 (në 2023). Asnjë grua kryefamiljare nuk ka përfituar në këto tre vite. Vetëm 1 familje me anëtar me aftësi të kufizuara përfituese çdo vit. Nuk ka pasur përfitues nga komuniteti Rom/Egjiptian në asnjë vit.

Ndërkohë që numri i familjeve përfitues të NE është rritur vihet re se fondi vjetor nga shërbimi Social Shtetëror ka shënuar rritje nga 470,832 lekë (2021) në 632,424 lekë (2023), një rritje prej afro 34.3% në fondin total.

Financimi nga Shërbimi Social Shtetëror mbetet baza kryesore për përfituesit në Bashkinë Libohovë. Në vitin 2022 ka një rënie të lehtë (nga 10 në 8 përfitues), por më 2023 numri rikthehet në të njëjtat nivele si 2021. Kjo tregon një stabilitet të përgjithshëm në ofrimin e ndihmës nga Shërbimi Social Shtetëror, me ndonjë luhatje të vogël ndër vite.

Financimi nga fondi 6% ka qenë shumë i kufizuar në vitet 2021–2022. Në 2023 ka një trefishim të përfituesve, çka tregon një rritje të vëmendjes ndaj individëve që përfitojnë nga ky fond (në mënyrë të veçantë persona me aftësi të kufizuara ose kategori shumë vulnerabël). Megjithatë, në total, kjo mbetet një pjesë shumë e vogël e përfituesve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Ndihma direkte nga Bashkia ka qenë e qëndrueshme në 2021 dhe 2022 (8 përfitues çdo vit). Në vitin 2023 ka një rritje me 37.5% (nga 8 në 11 përfitues). Tregon një angazhim në rritje të nivelit lokal për të mbuluar nevojat e popullsisë që nuk mbulohet nga Sh.S.Sh apo nga fondi 6%. Veçanërisht për njësinë administrative të Zagorisë, ndihma nga Bashkia është i vetmi burim financiar për tre vitet e analizuara




*Grafiku 1. Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike*

**Burimi: Plani Social i Bashkisë Libohovë 2025 – 2028**

Në Bashkinë Libohovë, Njësia Administrative me numrin më të lartë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike është Libohova, ndërsa me numrin më të vogël është Zagoria. Ky tregues lidhet ngushtë edhe me numrin total të familjeve që janë të lokalizuara në secilën prej Njësive Administrative. Në këtë kuadër, është me rëndësi të vlerësojmë përqindjen e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike kundrejt numrit total të familjeve që jetojnë në secilën Njësi Administrative.

*Tabela 1. Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike sipas Njësive Administrative*

| Njesi Administrative | Nr. Familjeve Total | Familje me Ndihme Ekonomike | % |
|---|---|---|---|
| Libohovë | | 53 | |
| Qendër | | 83 | |
| Zagorie | | 32 | |

**Burimi: Llogaritje të autorëve**

Nga llogaritjet e bëra, Njësia Administrative që ka përqindjen me të lartë të familjeve me ndihmë ekonomike është Qyteti, ndërsa përqindjen më të ulët Zagoria

- Struktura e popullsisë

*Tabela 2. Popullsia sipas grupmoshave*






REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Këto të dhëna tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së Libohovës është mbi 65 vjeç, duke përbërë 30.7% të totalit.

Të dhënat tregojnë se Libohova ka **shumë pak të rinj** (Fëmijët (0–14 vjeç) janë vetëm 312 fëmijë shifër kjo shumë e ulët (rreth 11.3% e popullsisë), nëse e krahasojmë me mesataren kombëtare që është 15.6%, Libohova ka më pak fëmijë.) dhe **shumë të moshuar**.

Përqindja e lartë e banorëve mbi 65 vjeç tregon për një tendencë të plakjes së popullsisë në këtë bashki. Kjo mund të ketë ndikime në shërbimet sociale dhe ekonominë lokale, duke kërkuar politika të përshtatshme për të përballuar nevojat e një popullsie në plakje.

Me vetëm 11.3% të popullsisë nën 14 vjeç, ka një rënie të lindshmërisë dhe një potencial të ulët për rritje natyrore të popullsisë në të ardhmen. Ky fakt mund të ndikojë në shkollat dhe shërbimet për fëmijë në zonë. Përqindja e popullsisë në moshë pune (15–64 vjeç) është 58.0%, që është më e ulët se mesatarja kombëtare dhe kjo mund të ndikojë në fuqinë punëtore dhe zhvillimin ekonomik të zonës.

Ka **rrezik serioz për tkurrje të mëtejshme demografike** nëse nuk merren masa për:

- Mbështetje sociale dhe shëndetësore për të moshuarit.
- Nxitje të qëndrimit të të rinjve ose tërheqje të familjeve të reja (me politika sociale, ekonomike, punësimi).

Gjithashtu interpretimi i të dhënave demografike na tregon se nevojitet **zhvillim i shërbimeve të përshtatura për popullsinë e moshuar**: shërbime shëndetësore, kujdes social, etj.

*Grafiku 1 Struktura e grupmoshave të popullsisë në Bashkinë Libohove në vitin 2023*

*Grafiku 2. Përqindja sipas grupmoshave*




**Burimi: Bashkia Libohovë**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Sipas të dhënave nga Shërbimet e Punësimit, në Bashkinë Libohovë janë identifikuar 274 persona të papunë (100%).

**Sipas gjinisë:**

Gra: 50.4% (138 persona)
Burra: 49.6% (136 persona)

**Sipas arsimit:**

Me arsim 9-vjeçar: 36.5% (100 persona)
Me arsim të mesëm: 17.9% (49 persona)
Me arsim universitar: 8.4% (23 persona)
Kjo strukturë arsimore tregon një potencial të kufizuar për punësim cilësor, sidomos në tregun lokal që kërkon aftësi teknike ose profesionale.

**Struktura sipas moshës:**

Mbi 40 vjeç: 29.2% (80 persona)
Grupmosha 30–39 vjeç: (nuk jepet numri i saktë, ndaj nuk mund të llogaritet përqindja e saktë)
Të rinjtë 16–24 vjeç: përmenden si shqetësues, por pa shifër konkrete

**Vërejtje:**

Kategoritë vulnerabël (romë, emigrantë të kthyer, gra kryefamiljare) rezultojnë me përqindje shumë të ulët në statistika, çka mund të lidhet me nën-raportim ose mosregjistrim.

**Të dhëna mbi zhvillimin ekonomik:**

Sektorët e ekonomisë dhe kontributi në ekonominë lokale. Për shkak të natyrës mikse të ekonomisë lokale, banorët janë të punësuar në sektorë të ndryshëm si bujqësi, blegtori dhe shërbime. Struktura e punësimit në këto sektorë paraqitet si më poshtë: në bujqësi janë të punësuar 25% e forcës aktive të punës, në industri rreth 45%, dhe në shërbime 30%. Këta tregues flasin për një strukturë ekonomike me natyrë urbane, duke u larguar gjithmonë e më tepër nga karakteristikat e dikurshme rurale të zonës.Ekonomia e Bashkisë së Libohovës karakterizohet nga mbizotërimi i bizneseve të vogla dhe familjare. Numërohen në total rreth 70 biznese, nga të cilat pjesa më e madhe e zhvillojnë aktivitetin në territorin e njësisë administrative Libohovë dhe Qender. Tregtia dhe shërbimet përqendrojnë mbi gjysmën e aktiviteteve të biznesit në total. Sektori i shërbimeve është më i zhvilluari, ai është përgjegjëse për gati gjysmën e outputit dhe punësimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Numri i popullsisë në Bashkinë Libohovë është 2,765 banorë sipas censusit 2023, ndërsa sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në këtë Bashki janë të rregjistruar 6844 banorë, pjesë e 2,350 familjeve.

## 1.5 Dokumenta strategjike ne nivel kombetar dhe vendor

Pas viteve 1990, me rritjen e pabarazive territoriale, nevoja për strehim social dhe të përballueshëm në Shqipëri ka ardhur gjithnjë e më shumë në rritje. Në vitin 2016 është hartuar e miratuar **"Strategjia Kombëtare e Strehimit Social 2016-2025"** e cila i ka hapur rrugën një sërë ndryshimesh të rëndësishme në sektorin e strehimit në Shqipëri. Ndër më të rëndësishmet, mund të përmendethartimi i ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social". Ky ligj sjell risi të shumta në fushën e strehimit dhe është në zbatim të drejtpërdrejtë të qëllimeve të SDG 11 si dhe bazohet në parimet e Kartës së Gjenevës. Ligji zgjeron grupet e përfituesve të strehimit social dhe njëkohësisht zgjeron dhe diversifkon programet e strehimit të cilat zbatohen në nivel vendor nga bashkitë.

**Plani i Përgjithshëm Vendor** si dokumenti bazë për përcaktimin e politikave të zhvillimit të territorit, i cili zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të ndërtimit. PPV e Bashkisë Libohovë është në zbatim.

**Plani Social i Bashkise Libohovë (2025 – 2028)** është hartuar si detyrë e vendosur për Bashkitë sipas Ligji nr. 121/2016 "Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë". Hartimi i këtij plani i ka paraprirë Raportit të Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror për Bashkinë Libohovë, i cili identifikon grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë, madhësinë e këtyre grupeve, shtrirjen e tyre në territor, shërbimet egzistuese që adresojnë nevojat e tyre, si dhe kapacitetet e burimet njerëzore e financiare të Bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Bazuar në Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale, por edhe në Ligjin Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", sikurse Ligji nr.121, datë 21.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Bashkitë janë aktorët kryesorë në ngritjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel komunitar dhe si të tilla ato duhet të kenë kapacitetet e nevojshme veçanërisht në drejtim të planifikimit, organizimit, administrimit dhe kontrollit të këtyre shërbimeve

**Plani buxhetor afatmesëm** miratohet në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 34 të ligjit Nr.9936, ku çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore. NJQV janë përgjegjëse edhe për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesem.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

## 2. Vlerësim i thelluar i situatës ekzistuese

### 2.1 Analizë e trendeve demografike e social-ekonomike të popullsisë

Popullsia e Bashkisë Libohovë eshte 2765 banorë sipas censusit 2023, ndërsa sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në këtë Bashki janë të rregjistruar 6844 banorë, që përbëjnë 2,350 familje. Pjesa më e madhe e popullsisë është e përqendruar në Njësinë Administrative Libohovë (rreth 48.% e popullsisë), 52 % e popullsisë është vendosur në Njësinë Administrative Qendër dhe Njësinë Administrative Zagorie. Sipërfaqja e bashkisë është 248. 24 km$^2$, me një densitet prej 28.83 banorë/km$^2$.

*Tabela 3. Popullsia për çdo njësi administrative në Bashkinë Libohovë*

| | Popullsia | Nr. Familjesh |
|---|---|---|
| Libohovë | 1329 | 567 |
| Njësia Administrative Qendër | 825 | 312 |
| Njësia Administrative Zagorie | 203 | 94 |

*Grafiku 4. Popullsia sipas grupmoshës dhe Njësive Administrative*

Struktura e popullsisë sipas moshave shpreh se në rreth 11.3 % e popullsisë është nën moshën 15 vjeç, të moshuarit zënë rreth 30.7 % të popullsisë dhe 58 % e popullsisë i përket grupmoshës 16-64 vjeç, që përkon me popullsinë e aftë për punë. Njësia me përqindjen më të lartë të të moshuarve (65+ vjeç) është Zagoria, ndërsa njësia me përqindjen më të lartë të të rinjve (0-15 vjeç) është Libohova .

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Migracioni dhe treguesit e lindjeve dhe vdekjeve janë faktorët bazë që shërbejnë për të vlerësuar trendin e popullsisë. Në këtë kuadër, një tregues shumë i rëndësishëm është të kuptuarit e dinamikës së popullsisë. Qarku i Gjirokastrës ka pasur një koefiçent bruto të lindjeve 8.6% per vitin 2024, ndërsa ai i vdekjeve 15.6% duke bërë që për këtë vit shtesa natyrore e popullsisë të ishte -410, me një koefiçent bruto të shtesës natyrore -7. Specifikisht, Bashkia Libohovës ka pasur një shtesë natyrore negative(-29) gjatë vitit 2025 dhe sipas tw dhwnave te Zyres te Gjendjes Civile migrimi i brendshëm neto në Bashkinë Libohovë, për 2025 ka qënë (65) banorë, . Siç shihet edhe në të dhënat e tabelës së mëposhtme, për periudhën 2023– 2025 ka pasur një rënie të vazhdueshme të numrit të lindjeve. Ndërsa vdekjet kanë pasuar nga një rritje gjatë vitit 2023 dhe një rënie gjatë 2024-2025 me -3 banorw.

*Tabela 5. Shtesa natyrore për Bashkinë Libohovë 2023-2025*

| | 2023 | | | 2024 | | | 2025 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shtesa Natyrore | Lindjet | Vdekjet | Shtesa Natyrore | Lindjet | Vdekjet | Shtesa Natyrore | Lindjet | Vdek jet |
| Bashkia Libohovë | -25 | 11 | 36 | -27 | 6 | 33 | -29 | 4 | 33 |

**Burimi: Bashkia Libohove-Zyra e Gjendjes Civile**

## 2.2 Analiza e zhvillimit ekonomik dhe aspektet financiare

### 2.2.1 Situata financiare e bashkisë

Burimet financiare në dispozicion të bashkisë Libohovë kanë qenë nw rritje në tre vitet e fundit nw efektin e tw hyrave nga transfertat ndërqeveritare . Në të kundërt, të ardhurat nga burimet e veta vendore shënuan pothuajse të njëjtin nivel të një viti më parë. Të ardhurat nga taksat vendore u ulwn me rënien e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme ndërsa, të ardhurat nga tarifat vendore shënuan ulje të lehtë krahasuar me vitin e mëparshëm.

*Tabela 6. Të ardhurat e Bashkisë Libohovë*

| | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|
| **A. Të ardhura vendore** | **11,782** | **15,686** | **14,284** |
| A1. Të ardhura nga taksat | 3853 | 5588 | 4808 |
| Tatimi i thjesht. mbi fitimin e BV | 55 | 493 | 100 |
| Taksa mbi pasuritë e paluajtshme | 3,668 | 4942 | 3891 |
| Taksa e hotelit | - | - | - |
| Taksa e ndikimit në infrastrukturë | 130 | 153 | 817 |
| A2. Të ardhura nga tarifat | 7929 | 10097 | 9475 |
| Tarifa për shërbimet publike | 1,487 | 5321 | 4395 |
| Tarifa për zënien e hapësirave publike | 23 | 25 | 57 |
| A3. Të ardhura të tjera | 6419 | 4751 | 5023 |
| **B. Transferta ndërqeveritare** | **186,563** | **232,513** | **229,401** |
| B1. Taksa të ndara | | - | - |
| B2. Tr. pakusht & sektoriale | 127,234 | 124,068 | 160,303 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | |
|---|---|---|---|
| B3. Transferta të kushtëzuara | 59,329 | 108,445 | 69,098 |
| **TE ARDHURA TOTALE** | **198,345** | **248,199** | **243,685** |

**Burimi: Bashkia Libohovw-Zyra Tatim,Taksa**

Shpenzimet e bashkisë Libohovë nw vitin 2025 shënuan rritje nw "çështjet ekonomike" (+21.9%) dhe "arsim" (+14.1%) krahasuar me vitin 2024, "shërbimet e përgjithshme publike" (+12.6%), "mbrojtja sociale" ku përfshihen ndër të tjera shpenzimet që lidhen me transfertat për buxhetet familjare dhe pagesën e paaftësisë.

*Tabela 7. Shpenzimet e Bashkisë Libohovë*

| | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|
| 1. Shërbimet e përgjithshme publike | 16,776 | 18,108 | 21,971 |
| 2. Rendi dhe siguria publike | 1,056 | 1,056 | 1,056 |
| 3. Çështjet ekonomike | 42,680 | 48,880 | 64,739 |
| Çështjet ekonomike, tregtare, punës | - | - | - |
| Bujqësia, pyjet, | 5,727 | 8,347 | 10,552 |
| Transporti | - | - | - |
| Industri te tjera | - | - | - |
| 4. Mbrojtja e mjedisit | - | 6,640 | 7,823 |
| 5. Strehimi, komoditetet e komunitetit | - | - | - |
| Strehimi, urbanistika vendore | - | - | - |
| Zhvillimi i komunitetit | | | |
| Furnizimi me ujë | 2,343 | 1,179 | 8,501 |
| 6. Shëndetësia | - | - | - |
| 7. Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare | 453 | 2,054 | 1,063 |
| 8. Arsimi | 11,677 | 9,959 | 11,290 |
| Arsimi parashkollor dhe fillor | 10,014 | 8,152 | 10,138 |
| Arsimi i mesëm | 1,663 | 1,807 | 1,152 |
| 9. Mbrojtja Sociale | 29,720 | 35,386 | 31,212 |
| **Shpenzime totale** | | | |

**Burimi: Bashkia Libohovw – Zyra e Financws**

Rritja e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për periudhën afatmesem synon forcimin e kapaciteteve administruese, nëpërmjet zgjerimit të bazës së taksapaguesve, si dhe duke marrë në konsideratë:

- Përpjekjet për të forcuar menaxhimin e të ardhurave, duke rritur efikasitetin në mbledhjen e tyre me qëllim zvogëlimin e hendekut tatimor në kuadër të luftës kundër evazionit fiskal dhe ekonomisë informale.
- Lehtësimin e procedurave në marrëdhëniet midis subjektve dhe familjeve.
- Ecurinë e realizimit të të ardhurave për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

### 2.2.2 Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik

Ndërmarrjet aktive në bashkinë Libohovë terma vjetor kanw patur njw qwndrueshmwri nw numwr.Në terma strukturorë, bizneset janë të përqendruara në prodhimin e të mirave dhe shwrbimeve dhe operojnë kryesisht në bujqësi dhe shwrbime. Në vitin 2024, ndërmarrjet aktive në prodhimin e të mirave shënuan rritje me rreth 3.2%. Në të kundërt, ndërmarrjet aktive në prodhimin e të mirave u pakësua me rreth 10 fermer.

*Tabela 9. Ndërrmarrje aktive në Libohovë*

| | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|
| **Gjithsej** | **124** | **128** | **114** |
| **Prodhuesit e të mirave** | **68** | **69** | **58** |
| Bujqësi, pyje, peshkim | 62 | 53 | 52 |
| Industria | 4 | 4 | 4 |
| Ndërtimi | 2 | 2 | 2 |
| **Prodhuesit e shërbimeve** | **56** | **59** | **56** |
| Transport & magazinim | 1 | 1 | 1 |
| Akomodimi & shërb. ushqimore | 51 | 53 | 50 |
| Informacion & komunikacion | 2 | 2 | 2 |
| Shërbime të tjera | 2 | 3 | 3 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Burimi: Bashkia Libohovw

*Tabela 10. Punësimi sipas degëve të ekonomisë në secilën nga Njësitë Administrative*

| Njësia Administrative | Niveli i punësimit në Bujqesi | Niveli i punësimit në Industri | Niveli i punësimit në Shërbime |
|---|---|---|---|
| Libohovë | 15% | 50% | 35% |
| Qendër | 30% | 45% | 25% |
| Zagori | 85% | 5% | 10% |

**Burimi: Bashkia Libohovw**

Analiza e strukturës së punësimit në Bashkinë Libohovë tregon se sektori dominues është industria, ku angazhohet rreth 45% e të punësuarve. Megjithatë, kjo peshë e lartë nuk lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin industrial brenda territorit të bashkisë, por reflekton kryesisht punësimin e banorëve në ndërmarrje dhe aktivitete ekonomike në zonat fqinje, veçanërisht në Bashkinë Dropull. Ndërkohë, bujqësia mbetet një sektor i rëndësishëm, sidomos në njësitë më rurale si Zagoria, dhe Qender, ndërsa shërbimet kanë një rol më të theksuar në qendrën urbane të Libohovës."

## 2.3 Analiza e Grupeve Vulnerabël

### 2.3.1 Personat me aftësi të kufizuar dhe invalidë

Të dhënat tregojnë që numri i personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Libohovë është rreth 122 banorë, ose ndryshe 1.7 % e popullsisë. Numri i personave *invalid të punës* rezulton më iulët se personat me aftësi të kufizuara . Numri më i lartë edhe i personave me aftësi të kufizuara dhe invalidë të punës është në Libohovë.Duke qënë se pjesa më e madhe e këtij grupi jetojnë në qytet, e kanë më të lehtë për të marrë shërbimet spitalore dhe arsimore, duke bërë që aksesi në këto shërbime të jetë relativisht i kënaqshëm.

*Tabela 11. Numri i personave me PAK dhe Invalidë Pune*

| Njesia Administrative | PAK | Invalid Pune |
|---|---|---|
| Libohovë | 64 | - |
| Njësia Administrative Qendër | 44 | - |
| Njësia Administrative Zagorie | 14 | - |

Burimi: Plani Social i Bashkisë Libohovë 2025- 2028

## 2.4 Analiza e tregut te banesave

Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Libohovë, duke filluar nga viti 2015, kjo bashki ka paraqitur luhatje të numrit të lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja. Siç mund të shihet edhe në grafikun e paraqitur më poshtë, fillimisht konstatohet një rritje graduale e numrit të lejeve të ndërtimit duke filluar nga viti 2015 deri në vitin 2019, ku gjatë këtij të fundit arrihet

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

dhe niveli maksimal me rreth 8-10 leje ndërtimi të miratuara në vit. Pas vitit 2019, deri në vitin 2022, vihet re një rënie e numrit të lejeve të ndërtimit, duke zbritur në rreth 3-5 leje në vit, e ndikuar nga faktorë si emigracioni, kërkesa e kufizuar për banesa të reja në zonat rurale, si dhe pasiguritë ekonomike të periudhës.

*Grafiku 7. Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja*

Një potencial të mundshëm, i cili duhet marrë konsideratë për ofrimin e banesave sociale me qira, përbëjnë dhe banesat e pabanuara apo që përdoren për qëllime dytësore ose sezonale. Për të bërë një

analizë të kësaj situate, janë mbledhur të dhënat nga Bashkia Libohovë dhe rezultati është paraqitur në tabelë e mëposhtme:

*Tabela 12. Numri i banesave sipas qëllimit të përdorimit*

| | Numri i Banesave | Banesa të banuara | Banesa për qëllime dytësore apo sezonale | Banesa të pabanuara |
|---|---|---|---|---|
| Libohovë | 650 | 450 | 110 | 90 |
| Njësia Administrative Qendër | 900 | 580 | 160 | 160 |
| Njësia Administrative Zagori | 450 | 220 | 140 | 90 |
| Gjithsej | 2000 | 1250 | 410 | 340 |

Në territorin e Bashkisë Libohovë numri i banesave rezulton të jetë rreth 2000, nga të cilat 1250 janë të banuara (rreth 62.5%) dhe rreth 410 banesa përdoren për qëllime dytësore apo sezonale (rreth 20.5%), ndërsa 340 banesa rezultojnë të pabanuara (rreth 17%).
Kjo tregon një potencial të konsiderueshëm për rikthimin në përdorim të stokut ekzistues, veçanërisht në funksion të programeve të banesave sociale.

Një indikator i rëndësishëm në analizën e tregt të banesave është dhe mosha e tyre ose periudha e ndërtimit. Konsiderohet i rëndësishëm për të vetmin fakt sepse jep informacion në lidhje me trendin e ndërtimeve ndër vite. Në lidhje me këtë infromacion rezultojnë të dhënat si më poshtë, të cilat janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike dhe janë të specifikuara sipas Njësive Administrative të Bashkisë Libohovë:

*Tabela 13. Mosha e ndërtesave për qëllime banimi në Bashkinë Libohovë*

| | Periudha e ndërtimit | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Para 1990 | 1991-2000 | 2001-2010 | Pas 2010 |
| Libohovë | 65% | 15% | 12% | 8% |
| Njësia Administrative Qendër | 70% | 12% | 10% | 8% |
| Njësia Administrative Zagori | 80% | 10% | 6 % | 4% |

*Grafiku 8. Ndërtesat sipas vitit të ndërtimit dhe Njësive Administrative*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBO...

## 2.5 Analiza e nevojave për Strehim Social dhe të përballueshëm

Në këtë çështje fokusi është analiza e programeve që aplikohen, frekuenca, kosto dhe burimet e financimit për secilin program, raportin midis kërkesave dhe përfituesve në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër do të identifikohen sfidat dhe praktikat e njxerra nga aplikimi i këtyre programeve.

Për të realizuar planin 5-vjeçar të Strehimit Social, do të analizohen kërkesat specifike të Bashkisë së Libohovës për secilin prej programeve dhe sa mund të përmbushen ato.

Bazuar në Ligjin nr.92323, programe sociale strehimi janë "programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekare" (neni 2, pika 3). Sipas ligjit nr. 22/2018, janë të aplikueshme 6 programe strehimi, përkatësisht:

1. Programi i banesave sociale me qira
2. Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri
3. Programi i banesave me kosto të ulët
4. Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi
5. Programi për krijimin e banesave të përkohshme
6. Programi i banesave të specializuara

Programi i banesave sociale me qira

Nëpërmjet këtij programi jepen me qira banesa në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social. Ky program mbështetet nga mekanizmi i subvencionit të qirasë, i cili kryhet nga Qeverisja Vendore dhe Qeverisja Qëndrore (nëse kërkohet).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË









REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Financimi i këtij programi bëhet nëpërmjet:




<u>Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri</u>




Realizimi i këtij programi bëhet nëpërmjet granteve që jepen për bashkitë:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Përfituesit:

Ky program është për ata që nuk kanë strehim të përshtatshëm, ku përparësi kanë:

- a) personat me aftësi të kufizuara;
- b) individët me statusin e jetimit;
- c) familjet e policëve të rënë në detyrë; ç) të moshuarit;
- d) komuniteti rom;
- dh) komuniteti egjiptian;
- e) komunitetet e zonave rurale;
- ë) prindërit e vetëm;
- f) viktima të trafkimit / viktima të mundshme të trafkimit;
- g) viktima të dhunës në familje.

Financimi i këtij programi bëhet nëpërmjet:

- Financimi kryesor jepet nga buxheti i shtetit
- Bashkitë bashkë-financojnë jo më pak se përqindja e caktuar me udhëzim të ministrit të fnancave dhe ekonomisë, bazuar në nivelin e të ardhurave për frymë të bashkisë
- Çdo burim tjetër financimi nxitet me sistem pikëzimi

<u>Programi i banesave me kosto të ulët</u>

Banesë me kosto të ulët (BKU) konsiderohet banesa që plotëson të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi, që është e paracaktuar për t'u disponuar në pronësi nga përftuesi, nëpërmjet formave të ndryshme të lehtësimit nga institucionet shtetërore.

Realizimi i këtij programi bëhet:

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA LIBOHOVË

A. Me investime në ndërtime të reja, kur vlerat e tregut janë me të larta se kostoja e ndërtimit

- shiten me çmim nën vlerën e tregut, por jo nën vlerën e kostos së ndërtimit

B. Me investime për blerje në tregun e lirë në rastet kur vlera e banesës në tregun e lirë është më e ulët se kostoja e ndërtimit.

C. Me subvencione për mbulimin e interesave të kredisë për blerjen e banesave në treg të lire.

Përfituesit:

Përftojnë familje me të ardhura më të ulëta se mesatarja që:

- nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnje transaksion për tjetërsimin e pronësisë në 5 vitet e fundit
- zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;
- janë të zhvendosura nga banesat

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

A. Financimi i BKU

- Buxheti i Shtetit
- Fondet e Bashkisë
- Fondet e institucioneve Publike (Enti Kombëtar I Banesave)
- Donacione
- Kredi
- Nismë private

B. Blerja e BKU

- Financime nga buxheti I bashkisë
- Subvencionimi i interesave të kredive nga buxheti i shtetit dhe/ose bashkive
- Granti i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët (Q. Qendrore) mbulon 10% të vlerës së banesës

<u>Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi</u>

Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin bëhet për ndërtimin e banesave sociale, në bazë të dokumenteve të planifkimit qendror e vendor, dhe përfshin hartimin dhe miratimin e projektit të ndërtimit, deri në përfundimin e tij.

Realizimi i këtij programi bëhet:

A. Zhvillimi i një zone me qëllim strehimin realizohet kur toka është:

- e zënë me ndërtime pa leje që nuk mund të legalizohen.
- e zënë me ndërtime të vjetra industriale, jo funksionale, në pronësi publike ose private:
- e lirë në pronësi të shtetit ose private

B. Ndërtim banese nga vetë familja, sipas kushteve të riparcelizimit të vendosura nga bashkia

Përfituesit:

Përparësi kanë familjet/ individët e pastrehë që kanë siguruar strehimin në:

- - ndërtime të palegalizuara, që nuk mund të legalizohen;
- - zonat e vjetra industriale, të zëna nga individë të pastrehë, pa autorizime përkatëse për strehim

Financimi i këtij programi bëhet nëpërmjet:

- Partneritet Publik Privat
- Buxheti i shtetit
- Buxheti bashkiak

<u>Programi për krijimin e banesave të përkohshme</u>

Janë objekte ose pajisje që montohen dhe çmontohen lehtë dhe që shërbejnë për strehim të përkohshëm, me afat deri në dy vjet.

Realizimi i këtij programi bëhet:

Strehët duhet të plotësojnë kushtet:

- Vendodhje e përshtatshme
- Mbrojtje nga kushtet atmosferike
- Infrastrukturë e përshtatshme sanitare

Përfituesit:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

- Refugjatë
- Individët që zhvendosen nga vendbanimi për shkak të fatkeqësive natyrore a njerëzore
- Individët që zhvendosen për shkak të investimeve publike ose private dhe nuk përfitojnë kompensim, kur nuk ka alternative
- Emigrantë e rikthyer
- Personat e pastrehë, që banojnë në mjedise që nuk klasifkohen si vende për banim

Financimi i këtij programi bëhet nëpërmjet:

- Fondet e buxhetit të shtetit
- Fondet e bashkisë
- Donacione
- Kredi
- Financim nga institucione publike ose private

Programi i banesave të specializuara

Janë banesat në të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore adresojnë një nevojë specifke strehimi për grupe të vecanta.

Realizimi i këtij programi është i njëjtë me programin BSQ dhe tipologjitë e banesave janë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

- Banesat e specializuara për të moshuarit dhe/ose PAK
- Banesat e specializuara për viktimat e trafkimit dhe dhunës në familje
- Banesat e specializuara për të miturit 14-18 vjeç ose të rinjtë 18-21 vjeç, pas lirimit ose kryerjes së programeve rehabilituese
- Banesat e specializuara për vajzat nëna

Fondi i banesave të specializuara sigurohet nga Bashkia:

- Investim në ndërtim
- Blerje në treg të lirë
- Marrje me qira

Përfitues:

- Të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara;
- Viktimat e trafkimit/ viktimat e mundshme të trafkimit;
- Viktimat e dhunës në familje;
- Fëmijët, të cilët janë pa kujdes prindëror ose janë marrë në mbrojtje, të miturit nga 14-18 vjeç ose të rinjtë nga 18- 21 vjeç, pas lirimit ose kryerjes së programeve të rehabilimit
- Vajzat nëna

Financimi i këtij programi bëhet nëpërmjet:

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA LIBOHOVË




Bashkia është përgjegjëse për prioritarizimin e aplikuesve, duke miratuar në Këshill Bashkiak sistemin e pikëzimit vit pas viti, në mënyrë të dedikuar për çdo program. Kriteret e pikëzimit janë të përcaktuara me ligj, ndërkohë që pesha e secilit vlerësohet dhe publikohet nga bashkia para se të shpallen përftuesit. Kriteret fokusohen në 4 kategori kryesore:

- Kushtet e strehimit: nëse familja nuk ka në pronësi një banesë / nëse banesa është e rrezikuar apo në zone të rrezikuar / nëse humbet banesa për shkak të vendimeve gjyqësore / shpronësimit, etj.
- Kushtet familjare: situata e të moshuarve, njëprindërore, etj
- Kushtet sociale: 15 kategori grupesh të cenueshme nga pikëpamja sociale
- Kushtet ekonomike: grupet në nevojë për ndihmë ekonomike

Aktualisht në Bashkinë Libohovë përdoren programe të strehimit social, që janë:

*Tabela 16.Fondet e alokuara nga Qeveria Qendrore në Bashkinë Libohovë për programet e strehimit*

### 2.5.1 Zbatimi i programit të banesave sociale me qira
### 2.5.2 Programi i Banesave me Kosto të Ulët
### 2.5.3 Programi për Përmirësmin e Kushteve të Banesave Ekzituese, deri në ndërtim tëri
### 2.5.4 Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin
### 2.5.5 Strehet e përkohshme

## 2.6 Analiza e trojeve potenciale per ndertim per qellime strehimi social

BASHKIA LIBOHOVE

KATEGORIA E PERDORIMIT TE TOKES







A0-1

## 3. Vizioni, Objektivat dhe Programet

### 3.1 Vizioni dhe sfidat kryesore të bashkisë

Shtëpia është themeli i suksesit në jetë për një indvid dhe një program për ndërtimin e shtëpisë mund të jetë themeli i suksesit kombëtar. Për këtë arsye, strehimi është një çështje e cila kërkon një zgjidhje të menjëhershme, të cilën bashkia ka si qëllim t'a adresojë nëpërmjet:

- Dhënies së informacionit të vazhdueshëm në lidhje me procedurat që duhen ndjekur për të aplikuar në programet e strehimit që bashkia mundëson
- Rritjes së aksesueshmërisë të të gjitha grupeve përfituese në programet e strehimit social
- Diversifikimit të programeve që bashkia aplikon për të mundësuar strehimin social
- Fuqizimi i instumentave financiarë për të rritur mundësitë për strehim social.
- Identifikimi i kërkesës dhe ofertës sa i takonvendndodhjes (banesat nuk janë të gatshme aty ku nevojiten) dhe sa i takon përballueshmërisëdhe arritshmërisë (programet ekzistuese janë të papërballueshme apo të papërshtatshme sa i takon modelit)
- Riorientimi i programeve sociale drejt grupeve në pozita të pafavorizuara

Autoritetet vendore kanë raportuar si problemin kryesor në ofrimin e strehimit social, mungesën e fondeve për t'i zgjeruar programet sociale: njësitë vendore nuk sigurojnë fonde të mjaftueshme për strehimin social dhe kapacitetet fiskale të bashkisë janë të dobëta (UNDP, 2014b).

Një ndër sfidat kryesore me të cilat bashkia do të përballet lidhet me prioritarizimin e grupeve të pafavorizuara ku përfshihen gratë e divorcuara, komuniteti egjiptian dhe rom, familjet me ndihmë ekonomike, PAK, etj., sepse në këtë mënyrë përcaktohet më mirë edhe kërkesa për strehim social. Një tjetër sfidëështë dhe identifikimi i aseteve që bashkia zotëron dhe mund të përdorë me qëllim ofrimin e strehimit social. Në këtë kuadër **bashkia do të sigurojë që 60% e atyre të cilësuar në grupet e mësipërme të kenë akses në strehim të përballueshëm.**

Problematika të tjera përfshijnë: autoriteteve vendore u mungon përvoja për ofrimin e strehimit social; nuk kanë kryer ndonjë studim për të analizuar situatën; dhe kanë probleme sa i takon rregullimit të territorit. Për zgjidhjen e tyre po realizohet hapi i parë, i cili konsiston në hartimin e planit 5-vjeçar të strehimit, duke krijuar një mjedis mbështetës për zhvillimin e sektorit të strehimit social.

### 3.2 Qëllimet dhe parimet

Pa dyshim që ka njerëz me të ardhura të ulëta dhe që përballen me disavantazhe, duke bërë që të mbeten pas në tregun aktual të banesave. Strehimi konsiderohet një nevojë jetike dhe si e tillë është e domosdoshme për zhvillimin e një komuniteti. Bashkia e Libohovës merr në konsideratë parimet e Strategjisë Kombëtare të Strehimit Social për të hartuar planin 5-vjeçar të Strehimit Social, të cilat janë si më poshtë:

- Nevojat për strehim të familjeve me të ardhura të ulëta dhe, sidomos, të grupeve në pozita të pafavorizuara (siç përcaktohet në ligj) përbëjnë prioritet.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

- Politika e strehimit social është rezultat i një qasjeje të integruar të çështjes së strehimit mbështetur në parimet e gatishmërisë, arritshmërisë dhe përballueshmërisë të alternativave për strehim cilësor.
- Sektori i strehimit ndërvepron me sektorë të tjerë, si për shembull arsimi, shëndetësia, punësimi, dhe mbrojtja sociale, dhe ndikon mirëqenien sociale dhe ekonomike të familjeve.

Gjithashtu, për të realizuar vizionin e planit të strehimit dhe objektivave të tij, duhet të respektohen parimet udhëzuese të përcaktuara në Strategjinë e Strehimit Social të cilat janë si më poshtë:

- Gatishmëria

Sipas këtij parimi, është qartazi e rëndësishme që banesat t'u jepen përfituesve të synuar, fakt që nënkupton se ka banesa të gatshme. Këto mund të jenë banesa ekzistuese ose të ndërtuara rishtazi, për sa kohë që këto opsione strehimi janë të përshtatshme për grupin e synuar dhe ndodhen në vendet ku nevojiten.

- Përballueshmëria

Strehimi i përballueshëm me cilësi të mirë është themeli i komuniteteve të qëndrueshme. Pasja e një shtëpie me kosto të përballueshme siguron stabilitet për familjet dhe efekte anësore pozitive, si shëndet më i mirë, rezultate më të mira në shkollë për fëmijët etj.

- Arritshmëria

Në strehimin social arritshmëri quhet tërësia e rregullave dhe rregulloreve që u mundësojnë familjeve të kualifikohen dhe të përzgjidhen për strehim social. Kriteret e kualifikimit për strehim social duhet të jenë realiste për sa u përket grupeve të synuara. Identifikimi i grupeve të nënsynuara dhe vendosja e prioriteteve, si edhe vendosja e kuotave për grupet specifike të synuara, mund të rrisin arritshmërinë.

- Përshtatshmëria e paketës së përgjithshme të strehimit

Ekziston rreziku që gatishmëria, përballueshmëria dhe arritshmëria të vlerësohen në mënyrë teknokrate, së cilës i mungon një vlerësim solid i mjaftueshmërisë faktike të paketës së plotë të strehimit. Parimi i fundit shërben për të garantuar një interpretim të drejtpeshuar, tërësor, të integruar dhe të qëndrueshëm të tre parimeve të tjera.

## 3.3 Programet e propozuara (Objektivat afatgjata)

**Objektivi 1: Përmirësimi i kapaciteteve të njësive vendore në lidhje me strehimin social.**

*Nënobjektivi 1.1: Krijimi dhe zbatimi i një plani për ngritjen e kapaciteteve mbi përdorimin e sistemit elektonik.*

Stafi i cili do të jetë përgjegjës për procedurat e aplikimit, marrjen e informacionit, përpunimin e tij dhe nxjerrjen e rezultateve duhet të trajnohet mbi përdorimin e sistemit elektronik sipas një plani të përcaktuar për ngritjen e kapacitetit të tyre.

*Nënobjektivi 1.2: Rritja e kapaciteteve vendore për mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve për strehim në territortin e Bashkisë.*

Stafi duhet të ketë njohuri të nevojshme dhe të mjaftueshme në çeshtjet e strehimit social, problematikat e këtij sektori dhe të ofrojë zgjidhje potencialt. Për këtë arsye, stafi duhet të trajnohet në lidhje me mbledhjen e të dhënave specifike në lidhje me shërbimin e Strehimit Social. Ky staf duhet të gjenerojë edhe numrin e aplikimeve për secilin nga programet e strehimit, duke mundësuar në këtë mënyrë dhënien e informacionit të sakte, i cili ndihmon në hartimin e politikave të cilat do të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

ndihmonin në zgjidhjen e problematikës së strehimit. Me rëndësi të veçantë është dhe identifikimi i karakteristikave të aplikuesve.

*Nënobjektivi 1.3: Përditësim i regjistrit elektronik të aplikantëve që bëjnë kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social*

Regjistri elektonik duhet të përditësohet vazhdimisht me aplikimet e reja që bëhen për programet e strehimit social që ofron bashkia, me qëllim mundësimin e të dhënave sa më të sakta dhe aktuale në lidhje me kërkesat për strehim. Në këtë mënyrë, Bashkia mund të ndërmarrë nisma konkrete për zgjidhjen e kësaj problematike.

**Objektivi 2: Qasja në strehim të 60% të familjeve në pozita të pafavorizuara**

*Nënobjektivi 2.1: Identifikimi i grupeve në nevojë*

1.1.1 Hartimi i një plani sipas të cilit do të idnetifikohen grupet në nevojë
1.1.2 Vëzhgime në terren
1.1.3 Krijimi i databasës me grupet në nevojë/GIS
1.1.4 Përditësim i vazhdueshëm i databases

*Nënobjektivi 2.2: Lehtësimi i procedurave për aplikuesit e programeve sociale*

Qytetarët, e në veçanti grupet e pafavorizuara, duhet të informohen në lidhje me programet e strehimit social, sepse në këtë mënyrë evidentohen më mire nevojat e tyre specifike. Ky informacion i vjen në ndihmë subjekteve publike e private, të cilët investojnë në banesa sociale me qira ose kanë banesa të cilat duan/mund t'i japin me qira.

1.1.5 Dizenjimi i broshurave/fletepalosjeve me material informuese mbi mundësite e aplikimit dhe përfitimit.
1.1.6 Takime të vazhdueshme me grupet e pafavorizuara për t'i informuar mbi programet e strehimit.

*Nënobjektivi 2.3 Zhvillimi i subvencioneve të ndryshme dhe grante-ve të menjëhershme për strehimin e grupeve me të ardhura të mesme dhe grupeve në pozita të pafavorizuara në Bashki.*

Programet e strehimit duhet të jenë të arritshme për grupet në pozita të pafavorizuara. Në këtë kuadër, këto grupe duhet te asistohen me subvencione apo grante që të kenë mundësi të pëtfitojnë nga këto programe. Psh: për të përfituar bonusin e qerasë duhet që familja të ketë detyrimisht një nivel të caktuar të ardhurash për të përballuar qeranë.

2.3.1 Familjet që janë me ndihmë ekonomike: nëpërmjet subvencionimit të qirasë syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve.
2.3.2 Individët që janë me PAK: nëpërmjet subvencionimit të qirasë syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve.
2.3.3 Gra të divorcuara ose të dhunara: nëpërmjet subvencionimit të qirasë syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve.
2.3.4 Familjet që i përkasin komunitetit Rom dhe Egjyptian: nëpërmjet programit të përmirësimit të kushteve të banimit syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve.
2.3.5 Familjet që jetojnë në kushtë jo të mira: nëpërmjet programit të përmirësimit të kushteve të banimit syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve.

*Nënobjektivi 2.4: Zbatimi i masave të nevojshme për të nxitur përdorimin e ndërtesave të pashfrytëzuara dhe trojeve në Bashki.*

Bashkia duhet të përditësojë vazhdimisht inventarin e aseteve që ajo zotëron dhe që mund të shfrytëzohen për të ndërtuar godina në të cilat mund të strehoen familje sipas programeve të strehimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Gjithashtu, duhet të evedientohen të gjitha ndërtesat/apartamentet e pashfrytëzuara apo që përdoren për qëllime dytësore, të cilat mund të shërbejnë për strehim social.

**Objektivi 3: Diversifikimi i programeve që ofron bashkia në lidhje me strehimin social dhe mundësimi i aksesueshmërisë së tyre për të rritur numrin e familejeve përfituese me 60%.**

*Nënobjektivi 3.1: Identifikimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe karakteristikat e familjeve që kanë përfituar nga këto programme në Bashki.*

Ky nënobjektiv orienton mbi programet e kërkuara sipas karakteristikave të familjeve që aplikojnë për to.

*Nënobjektivi 3.2: Zgjerimi i alternativave të strehimit përmes programeve të orientuara për familjet me të ardhura të ulëta e të mesme dhe kryesisht ato të pafavorizuara me 50 – 60%.*

3.2.1 Zbatimi i programit Banesa Sociale me Qira

Subvencionim qiraje për XX familje

Menaxhim i Banesave Sociale për qira, që do përfitohen nga Programi i Zhvillimit për Qëllim Strehimin

3.2.2 Zbatimi i Programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit

Përmirësim i Kushteve të Banimit për XX familje (XX në vit)

3.2.3 Banesa me Kosto të Ulët

Aplikimi i programit BKU për trojet e identifikuara në pronësi të bashkisë

Aplikimi i programit për rikonstruktim të banesave ekzistuese publike për kthim fond banesash

3.2.4 Zhvillimi i Zonës për Strehim

3.2.Streha të Përkohëshme

Banesa të përkohshme të siguruara për familjet e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore (XX streha)

3.2.6 Banesa të specializuara

Studim para-fizibiliteti mbi mundësinë e përballimit të kostos operative të realizimit të Banesave të Specializuara në BS që do realizohen

Zbatim i programit në banesat sociale të realizuara

3.2.7 Subvencionimi i interesave të kredive

Zbatim i programit të subvencionimit të interesave të kredive për familjet e reja, ose me 1 prind të vetëm (XX familje)

## 3.4 Programi i detajuar

Në bazë të programeve të identifikuara më sipër, në tabelën e mëposhtme paraqiten në mënyrë të detajuar specifikimet për secilin prej tyre, ku përfshihen aktivitetet për nënobjektivat, kostot e përafërta, burimet e financimit, indikatorët matës, burimi i të dhënave dhe periudha kohore.

*Tabela 17. Programi i detajuar*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| Objektivi | Nënobjektivi | Aktivitete | Kosto e përafërt (ALL) | Burimi i financimit | Indikatori matës | Burimi i të dhënave | Periudha |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1: Përmirësimi i kapaciteteve të njësive vendore në lidhje me strehimin social.** | Nënobjektivi 1.1: Krijimi dhe zbatimi i një plani për ngritjen e kapaciteteve mbi përdorimin e sistemit e elektonik. | Draftimin e një manuali (në formë elektronike) për trajtimin e aplikimeve për secilin nga programet e strehimit. | Pa kosto | MFE | 1 manual | Bashkia | 2022-2023 |
| | Nënobjektivi 1.2:Rritja e kapaciteteve vendore për mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve për strehim në Bashki. | Trajnim i stafit lokal përgjegjës për përdorimin e sistemit online për shërbimin e strehimit social | Pa kosto | MFE | Staf i trajnuar | Bashkia | 2022-2023 |
| | Nënobjektivi 1.3:Përditësimi i regjistrit elektronik të aplikantëve që bëjnë kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social | Përditësimi i vazhdueshëm i regjistrit elektornik | Pa kosto | Bashkia | Numri i aplikimeve të reja në regjistrin elektronik | Bashkia | 2022-2023 |
| **Objektivi 2: Qasja në strehim të 50% të familjeve në pozita të pafavorizuara** | Nënobjektivi 2.1: Identifikimi i grupeve në nevojë | Hartimi i një plani sipas të cilit do të identifikohen grupet në nevojë | Pa kosto | Bashkia | Grupe të identifikuara | Bashkia/ Struktura përgjegjëse | 2022-2027 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Vëzhgim e në terren | Pa kosto | Bashkia | Evidenca dhe të dhëna të siguruara nga terreni | Bashkia / Struktura përgjegjëse / Institucione të tjera vendore / OJF lokale | 2022-2027 |
| | | Krijimi i bazës së të dhënave me grupet në nevojë / GIS | Pa kosto | Bashkia, Donator | Databaë` e grupeve në nevojë potencial për strehim dhe sistem GIS i populluar me të dhënat e strehimit | Bashkia/ Struktura përgjegjëse për Strehimin / specialistët e GIS | 2022-2027 |
| | | Përditësim i vazhdueshëm i bazës së të dhënave | Pa kosto | Bashkia, Donator | Bazë të dhënash e përditësuar | Bashkia / Struktura përgjegjëse për Strehimi/ specialistët e GIS | 2022-2027 |
| | <u>Nënobjektivi 2.2:</u> Lehtësimi i procedurave për aplikuesit e programeve sociale | Dizenjimi i broshurave/fletepalosjeve me material informuese mbi mundësite e aplikimit dhe përfitimit. | Sipas projektit | Bashkia ,Donator | Rritje e numrit të aplikimeve | Bashkia | 2022-2027 |
| | | Takime të vazhdueshme me grupet e pafavorizuara për t'i informuar mbi programet e strehimit. (2 takime në vit, për arsye se aplikimi për të përfituar nga programet e strehimit social bëhet me dy faza) | Pa kosto | Bashkia | 2 takime të realizuar çdo vit / 10 takime total për të informuar grupet në nevojë | Bashkia | 2022 - 2027 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nënobjektivi 2.3 Zhvillimi i subvencioneve të ndryshme dhe grante-ve të menjëhershme për strehimin e grupeve me të ardhura të mesme dhe grupeve në pozita të pafavorizuara në Bashkinë Libohovë. | | | | | | |
| | | 2.3.1 Familjet që janë me ndihmë ekonomike: nëpërmjet subvencionimit të qirasë syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve | Sipas Programit | Bashkia | Numri i familjeve që marrin me ndihmë ekonomike dhe janë të përfshira në programet sociale | Bashkia | 2022 - 2027 |
| | | 2.3.2 Individët që janë me PAK: nëpërmjet subvencionimit të qirasë syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve | Sipas programit | Bashkia | Numri i PAKqëjanë të përfshira në programet sociale | Bashkia | 2022-2027 |
| | | 2.3.3 Gra të divorcuara ose të dhunara: nëpërmjet subvencionimit të qirasë syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve | Sipas Programit | Bashkia | Numri i grave të divorcuara ose të dhunuara qëjanë të përfshira në programet sociale | Bashkia | 2022-2027 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2.3.4 Familjet që i përkasin komunitetit Rom dhe Egjyptian: nëpërmjet programit të përmirësimit të kushteve të banimit syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve | Sipas Programit | MFE | Numri i familjeve të komunitetit Rom dhe Egjyptian që janë përfitues të programit | Bashkia | 2022-2027 |
| | | 2.3.5 Familjet që jetojnë në kushtë jo të mira: nëpërmjet programit të përmirësimit të kushteve të banimit syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve | Sipas programit | MFE | Numri i familjeve që do të përfitojnë banesë të rikonstruktuar | Bashkia | 2022-2027 |
| | Nënobjektivi 2.4: Zbatimi i masave të nevojshme për të nxitur përdorimin e ndërtesave të pashfrytëzuara dhe trojeve në Bashkinë Libohovë. | Identifikimi i trojeve potenciale për strehim si: banesa të pashfrytëzuara, banesa që përdoren për qëllime sezonale apo dytësore, asetet në pronësi të bashkië, etj. | Pa kosto | Bashkia | Përdorimi I ndërtesave të pashfrytëzuara dhe trojeve Bashkinë/ Numri I familjeve që p♪7rfitojnë nga Përdorimi I ndërtesave të pashfrytëzuara dhe trojeve Bashkinë | Bashkia | 2022-2027 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 3: Diversifikim i i programeve që ofron bashkia në lidhje me strehimin social dhe mundësimi i aksesueshmërisë së tyre për të rritur numrin e familejeve përfituese me 60%** | Nënobjektivi 3.1: Identifikimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe karakteristikat e familjeve që kanë përfituar nga këto programme në Bashki. | | Pa kosto | Bashkia | Programet e aplikuara nga bashkia<br><br>Identifikim i karakteristikave e familjeve që kanë përfituar nga këto programme | Bashkia | 2022 - 2027 |
| | Nënobjektivi 3.2:Zgjerimi i alternativave të strehimit përmes programeve të orientuara për familjet me të ardhura të ulëta e të mesme dhe kryesisht ato të pafavorizuara me 50 – 60%. | | | | | | |
| | 3.2.1 Zbatimi i programit Banesa Sociale me Qira | - Subvencionim qiraje për XX familje | E percaktuar nga bashkia | Bashkia | Numri i familjeve të strehuara | Bashkia | Cdo vit |
| | | - Menaxhim i Banesave Sociale për qira, që do përfitohen nga Programi i Zhvillimit për Qëllim Strehimin | Kosto mirembajtje | Bashkia | Sipas projektit | Bashkia | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3.2.2 Zbatimi i Programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit | - Përmirësim Kushteve të Banimit për XX familje (XX në vit) | Percaktuar nga Ministria | MFE | Numri I familjeve të përfshira në program | MFE, Bashkia | |
| | 3.2.3 Banesa me Kosto të Ulët | - Aplikimi i programit BKU për trojet e identifikuara në pronësi të bashkisë | Sipas vlerësimit | EKB | Kontrata me EKB | EKB, Bashkia | |
| | | - Aplikimi i programit për rikonstruktim të banesave ekzistuese publike për kthim fond banesash | Sipas vlerësimit | EKB | Kontrata me EKB | EKB, Bashkia | |
| | 3.2.4 Zhvillimi i Zonës për Strehim | | | | | | |
| | 3.2.5 Streha të Përkohëshme | - Banesa të përkohshme të siguruara për familjet e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore (XX streha) | Varet nga fondet e qeverise dhe bashkise | Bashkia, MFE, AKMC, Donatorë | XX streha të siguruara | Bashkia, MFE, AKMC, Donatorë | |
| | 3.2.6 Banesa të specializuara | - Studim para-fizibiliteti mbi mundësinë e përballimit të kostos operative të realizimit të Banesave të Specializuara në BS që do realizohen | Varet nga fondet | Bashkia, Donatorë | Studim I realizuar | Bashkia, Donatorë | |
| | | - Zbatim i programit në banesat sociale të realizuara | | Bashkia, MFE, MSHMS | Banesa e specializuar funksionale | Bashkia | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3.2.7 Subvencionimi i interesave të kredive | - Zbatim i programit të subvencionimit të interesave të kredive për familjet e reja, ose me 1 prind të vetëm (XX familje) | Sipas aplikimit | MFE | Interesat e kredive të subvencionuara | MFE, Bashkia | 2023 - 2027 |

## 4. Monitorimi dhe Zbatimi

Plani 5 vjecar i Strehimit Social është parashikuar të zbatohet për një periudhë pesë vjeçare dhe zbatimi i tij është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Bashkisë, por mund të shikohet edhe mundësia e partneritetit me organizata të shoqërisë civile, donatorë, institucione publike lokale e rajonale, si dhe grupe të tjera interesi.

Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve të strukturave drejtuese, Këshillit Bashkiak dhe partnerëve të tjerë vendorë. Përgjegjës për monitorimin e zbatimit e Planit 5-vjecar të Strehimit Social do të jetë struktura përgjegjëse për strehimin social, duke marrë parasysh risqet e mundshme të parashikuara në këtë plan. Me miratimin e Planit të Strehimit, Bashkia do të bëjë përshtatjet respektive në Planin Buxhetor Afatmesëm.

Është e rëndësishme që krahas planit, të monitorohet vazhdimisht edhe situata e strehimit dhe grupeve vulnerabël në nevojë për strehim në bashkia. Në lidhje me monitorimin dhe kordinimin, plani parashikon veprimtari të përmirësimit të sistemit të të dhënave. Për këtë arsye, bashkia do të mobilizojë kapacitetet njerëzore për vëzhgimet në terren dhe përmirësimin e databases së strehimit. Gjithashtu, bashkia, do të angazhohet në informimin komunitetit në lidhje me mundësitë dhe programet e strehimit.

Monitorimi dhe zbatimi me efektivitet i këtij Plani 5 vjecar do të ndihmojë në arritjen e objektivave të tij si dhe adresimin e nevojave për strehim që kanë grupet me të ardhura të ulëta dhe të mesme dhe konkretisht grupet në pozita të pafavorizuara, në përputhje me gatishmërinë, arritshmërinë, përballueshmërinë dhe mjaftueshmërinë e programeve dhe projekteve të strehimit. Struktura përgjegjëse për monitorimin e këtij Plani do të vlerësojë progresin e arritur duke raportur në mënyrë pëeriodike, cdo vit mbi arritjen e treguesve të monitorimit të cilët janë detajuar në tabelën e mëposhtme.

### 4.1 Treguesit për monitorimin e zbatimit të vetë strategjisë

***Të gjithë treguesit do të maten dhe do të monitorohen nga Bashkia.***

*Tabela 18. Monitorimi i situatës së strehimit në Bashki*

| Treguesi | Synimi 2027 | Periodiciteti |
|---|---|---|
| Numri total i të pastrehëve | Të ulet me 30 - 50% | Cdo vit |

| | | |
|---|---|---|
| Popullimi me të dhëna i sistemit për të pastrehët | Të arrihet 100% popullimi me të dhëna | Cdo vit |
| Numri i aplikimeve | Të rritet me 50-70% për shkak dhe të rritjes së informimit të komunitetit | Cdo vit |
| Numri i përfituesve të programeve të strehimit social | Të rritet me 50% | Cdo vit |
| Numri i familjeve me ndihmë ekonomike që përfitojnë nga programet e strehimit | Të rritet me 50% | Cdo vit |
| Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga programet e strehimit | Të rritet me 50% | Cdo vit |
| Numri i personave PAK që përfitojnë nga programet e strehimit | Të rritet me 50% | Cdo vit |
| Numri i grave të dhunuara/ të divorcuara / vajzave nena etj që përfitojnë nga programet e strehimit | Të rritet me 50% | Cdo vit |
| Numrit të përfituesve nga subvencionimi I interesave të kredive | Të rritet me 50% | Cdo vit |
| Numri I përfituesve nga subvencionimi i qirasë | Të rritet me 50% | Cdo vit |
| Numri i familjeve që përfitojnë nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit | Të rritet me 50% | Cdo vit |
| Numri i cifteve të reja që kanë përfituar strehim | Të rritet me 5-10% | Cdo vit |

*Tabela 19. Monitorimi i zbatimit të strategjisë*

| Aktiviteti | Treguesi | Burimi i informacionit | Periodiciteti |
|---|---|---|---|
| Draftimin e një manuali (në formë elektronike) për trajtimin e aplikimeve për secilin nga programet e strehimit. | 1 manual | Bashkia | Viti parë |
| Trajnim i stafit lokal | Staf i trajnuar | Bashkia | Çdo vit |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | |
|---|---|---|---|
| përgjegjës për përdorimin e sistemit online për shërbimin e strehimit social | | | |
| Përditësimi i vazhdueshëm i regjistrit elektornik | Numri i aplikimeve të reja në regjistrin elektronik | Bashkia | Çdo vit |
| Hartimi i një plani sipas të cilit do të identifikohen grupet në nevojë | Grupe të identifikuara | Bashkia/ Struktura përgjegjëse | Çdo vit |
| Vëzhgime në terren | Evidenca dhe të dhëna të siguruara nga terreni | Bashkia / Struktura përgjegjëse / Institucione të tjera vendore / OJF lokale | Çdo vit |
| Krijimi i bazës së të dhënave me grupet në nevojë / GIS | Databazë e grupeve në nevojë potencial për strehim dhe sistem GIS i popullu ar me të dhënat e strehimit | Bashkia/ Struktura përgjegjëse për Strehimin / specialistët e GIS | Viti parë |
| Përditësim i vazhdueshëm i bazës së të dhënave | Bazë të dhënash e përditësuar | Bashkia / Struktura përgjegjëse për Strehimi/ specialistët e GIS | I vazhdueshëm sipas aplikimeve |
| Dizenjimi i broshurave/fletepalosjeve me material informuese mbi mundësite e aplikimit dhe përfitimit. | Rritje e numrit të aplikimeve | Bashkia | Çdo vit |
| Takime të vazhdueshme me grupet e pafavorizuara për t'i informuar mbi programet e strehimit.<br><br>(2 takime në vit, për arsye se aplikimi për të përfituar nga programet e strehimit social bëhet me dy faza) | 2 takime të realizuar çdo vit / 10 takime total për të informuar grupet në nevojë | Bashkia | 2 herë në vit |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIB...

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2.3.1 Familjet që janë me ndihmë ekonomike: nëpërmjet subvencionimit të qirasë syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve | Numri i familjeve që marrin me ndihmë ekonomike dhe janë të përfshira në programet sociale | Bashkia | Sipas thirrjeve për aplikime |
| 2.3.2 Individët që janë me PAK: nëpërmjet subvencionimit të qirasë syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve | Numri i PAKqëjanë të përfshira në programet sociale | Bashkia | Sipas thirrjeve për aplikime |
| 2.3.3 Gra të divorcuara ose të dhunara: nëpërmjet subvencionimit të qirasë syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve | Numri i grave të divorcuara ose të dhunuara qëjanë të përfshira në programet sociale | Bashkia | Sipas thirrjeve për aplikime |
| 2.3.4 Familjet që i përkasin komunitetit Rom dhe Egjyptian: nëpërmjet programit të përmirësimit të kushteve të banimit syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikuesve | Numri i familjeve të komunitetit Rom dhe Egjyptian që janë përfitues të programit | Bashkia | Sipas thirrjeve për aplikime |
| 2.3.5 Familjet që jetojnë në kushtë jo të mira: nëpërmjet programit të përmirësimit të kushteve të banimit syonohet të sigurohet strehimi për 60% të aplikesve | Numri i familjeve që do të përfitojnë banesë të rikonstruktuar | Bashkia | Sipas thirrjeve për aplikime |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | |
|---|---|---|---|
| Identifikimi i trojeve potenciale për strehim si: banesa të pashfrytëzuara, banesa që përdoren për qëllime sezonale apo dytësore, asetet në pronësi të bashkië, etj. | Programet e aplikuara nga bashkia. Identifikimi karakteristikave të familjeve që kanë përfituar nga këto programe | Bashkia | Identifikimi I trojeve do bëhet 1 herë në vit për secilin vit. Identifikimi I karakteristikave të familjeve që kanë përfituar nga këto programe do të bëhet sa sipas thirrjeve të hapura për aplikime |

| | | | |
|---|---|---|---|
| - Subvencionim qiraje për XX familje | Numri i familjeve të strehuara | Bashkia | Sipas thirrjeve të hapura për aplikime |
| - Menaxhim i Banesave Sociale për qira, që do përfitohen nga Programi i Zhvillimit për Qëllim Strehimin | | Bashkia | Sipas aplikimit |
| - Përmirësim Kushteve të Banimit për XX familje (XX në vit) | - Numri i familjeve përfituese të programit | MFE & Bashkia | |
| - Aplikimi i programit BKU për trojet e identifikuara në pronësi të bashkisë | Kontrata me EKB | EKB & Bashkia | Sipas thirrjeve të hapura |
| - Aplikimi i programit për rikonstruktim të banesave ekzistuese publike për kthim fond banesash | Kontrata me EKB | EKB & Bashkia | Sipas thirrjeve të hapura |
| - Banesa të përkohshme të siguruara për familjet e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore (XX streha) | XX streha të siguruara | Bashkia, MFE, AKMC, Donatorë | Sipas thirrjeve të hapura |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | |
|---|---|---|---|
| - Studim para-fizibiliteti mbi mundësinë e përballimit të kostos operative të realizimit të Banesave të Specializuara në BS që do realizohen | Studim I realizuar | Bashkia,<br><br>Donatorë | Çdo vit |
| - Zbatim i programit në banesat sociale të realizuara | Banesa especializuarfunksionale | Bashkia | Sipas thirrjeve të hapura |
| - Zbatim i programit të subvencionimit të interesave të kredive për familjet e reja, ose me 1 prind të vetëm (XX familje) | Interesat ekredive tësubvencionuara | MFE, Bashkia | Sipas thirrjeve të hapura |

## 4.2 Risqet e zbatimit

Identifikimi i risqeve duhet të evidentojë gjithashtu dhe kontrollet ekzistuese që kanë qëllim të modifikojnë, parandalojnë apo shmangin pasojat e padëshirueshme apo negative sikurse dhe probabilitetin e ndodhjes së tyre.

Identifikimi i nivelit të riskut, duke parashikuar se sa të mundshme janë dhe sa serioze mund të bëhen, është mjaft i rëndësishëm për të llogaritur efektin e tij dhe për të parashikuar masa të ndryshme për minimizimin dhe marrjen e vendimeve respektive në adresim të situatave të ndryshme.

Zbatimi me sukses i Strategjisë së Strehimit Social mund të vihet në vështirësi si pajosë e ekzistencës së disa risqeve, të cilat nëse nuk analizohen sic duhet dhe nëse nuk gjendet përqasja e duhur për ti adresuar, mund të sjellin vështirësi reale në suksesin e saj.

*Tabela 20. Risqet dhe masat për minimizimin e tyre*

| Risku | Niveli i riskut | Efekti | Masat për minimizimin e riskut |
|---|---|---|---|
| Angazhimi i njësive vendore për të zbatuar aktivitetet të këtij plani | I lartë | Ulja e mundësive per zbatimin e programeve të strehimit<br><br>Rritja e problematikave të strehimit | Rritja e angazhimi të drejtuesve të njësive vendore për ndjekjen e problematikave të strehimit.<br><br>Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në plan |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | |
|---|---|---|---|
| Njësite vendore nuk kanë buxhet të mfjatueshëm për programet e strehimit social. | I Lartë | Ulja e mundësive per zbatimin e programeve të strehimit<br><br>Rritja e problematikave të strehimit | Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në plan |
| Njësite vendore nuk kanë kanë kapacitetet teknike për zbatimin e programeve të e strehimit social. | Mesatar | Ulja e mundësive per zbatimin e programeve të strehimit<br><br>Rritja e problematikave të strehimit | Zbatimi i aktivitetit për rritjen e kapaciteteve vendore / trajnimi i stafit / bashkëpunim me grupe interesi |
| Mungesa e angazhimit të njësive vendore në lidhje me grumbullimin e të dhënave të nevojshme. | I lartë | Pasaktësi në të dhënat dhe ruajtjen e tyre në nivel vendor.<br><br>Mosnjohje e nevojave reale të këtyre grupeve. | Zbatimi i aktivitetit për rritjen e kapaciteteve vendore / trajnimi i stafit / bashkëpunim me grupe interesi |
| | | Ulje e mundësi per përfshirje të këtyre grupeve në programet e strehimit social. | |
| Mungesa e ekspertizës në analizimin e të dhënave dhe vleresimin e tyre. | Mesatar | Nuk mundësohet një analize e plotë në nivel vendor për nevojat për strehim.<br><br>Adresim jo i duhur i problematikave të strehimit | Zbatimi i aktivitetit për rritjen e kapaciteteve vendore / trajnimi i stafit / bashkëpunim me grupe interesi |
| Mungesa e stafit të dedikuar për probleme të strehimit në një pjesë të bashkive të reja. | I mesëm | Ulje e cilesisë së shërbimit për qytetarët. | Rritja e angazhimi të drejtuesve të njësive vendore në përcaktimin e personave përgjegjës për ndjekjen e programeve të strehimit.<br><br>Trajnimi i stafit për cështjet e strehimit |
| Mungesa e aplikimeve për programet e strehimit | Mesatar | Ulja e numrit të përfituesve nga programet e strehimit | Rritja e informimit nga ana e bashkisë për komunitetet përfituese. |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

| | | | |
|---|---|---|---|
| Vështirësi në zbatimin e Programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit | Mesatar | Aplikimet nuk miratohen nga MFE dhe nuk gjenden opsione të përshtatshme teknikisht për konvertim në Fond Banese | Propozohet që Bashkia të realizojë një projekt dhe të aplikojë pranë Entit Kombëtar të Banesave ose të realizohet ndërtimi nga e para, me mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. |
| Vështirësi në zbatimin e Programit për Banesa Sociale me Qira | Mesatar | Ka mungesë aplikimesh ose bashkia nuk ka buxhet për zbatimin e programit | Rritja e informimit nga ana e bashkisë dhe të kërkohet mbështetja e MFE, nëse buxheti i bashkisë nuk mjafton. |
| Vështirësi në zbatimin në zbatimin e Programit e Banesave me Kosto të Ulët | Mesatar | Enti Kombëtar i banesave nuk financon projektin | |
| Vështirësi në zbatimin në zbatimin e Programit për Zhvillimin e Zonës për Strehim | Mesatar | Mungesë e zonave për zhvillim | |
| Vështirësi në zbatimin në zbatimin e Programit për Strehët e përkohshme | Mesatar | Mungesë fondesh për zbatim | Propozohet që Bashkia të bashkëpunojë me qeverinë qëndrore për sigurimin e fondeve dhe vënien në disozicion të objekte të tjera publike për strehim |
| Vështirësi në zbatimin në zbatimin e Programit për | | Ky program mund të mos jetë në prioritetet e bashkisë, si dhe ka | Propozohet që Bashkia të rrisë bashkëpunimin me sektorit të strehimit dhe sektorit të mbrojtjes sociale për gjetjen e zgjidhjeve alternative më të mira të mundshme. |
| Rishikim i PPV në kuadër të nevojave të identifikuara në planin për strehim social | Mesatar | Vonesa në miratim të nismës/ rishikimt | Bashkia duhet të bashkëpunojë me AKPT për të adresuar komente në mënyrë eficente |
| Problem me asetet bashkiake | I lartë | Mungesë e regjistrimit të pronave bashkiake dhe mungesa e kapaciteteve për vlerësim | Bashkia të kërkojë bashkëpunimin e qeverisë qëndrore për përshpejtimin e procesit të regjistrimit dhe kalimit të pronësisë për asetet bashkiake të nevojshme për qëllim strehimi |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

## 5. Referencat


- UNECE (2014), Karta e Gjenevës e Kombeve të Bashkuara Mbi Strehimin e Qëndrueshëm, Komisioni Ekonomik I Kombeve Të Bashkuara Për Europën;
- Agenda 2030 for Sustainable Development and its Sustainable Development Goals (SDGs) Ministria e Zhvillimit Urban (2016), Strategjia e Strehimit Social 2016-2025, Tiranë;
- Udhëzues Për Përgatitjen e Programit Lokal 5-Vjeçar Për Strehimin Social (2021), hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave me asistencën teknike të MetroPOLIS sh.p.k, Co-PLAN-Instituti për Zhvillimin e Habitatit, mbështetur nga UNDP në kuadër të Programit Leave no one behind;
- Ligj nr. 22/2018 Për Strehimin Social, Kuvendi i Shqipërisë;
- Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Libohovë;
- Plani Social 2025 - 2028, Bashkia Libohovë;
- Plani Buxhetor Afatmesem 2025-2028
- Raporti Performancës 20025, Bashkia Libohovë;
- Mandro A., Rusi N., (2021) Raport Monitorimi I Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" në Njësitë e Qeverisjes Vendore, Tiranë;
- ISLAMI Gj. (2019) Social Housing Design and Construction In Albania, A Revieë of the Existing Norms and Proposed Guidelines, në kuadër të Programit "Leave No One Behind";
- Vjetari Rajonal Statistikor (2023), INSTAT, Tiranë;
- VKM Nr. 441, datë 22.7.2021 Për procedurat e përzgjedhjes, mënyrat e kontraktimit, format dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin;
- UDHËZIM Nr. 31, datë 18.11.2019 Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit.
- Udhezim-2020-08-26-33.për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme;
- http://www.instat.gov.al/
- http://financatvendore.al/
- https://planifikimi.gov.al/


REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË**
**KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

**Nr. 835 prot** **Libohovë më 06 .05.2026**

# VENDIM

**Nr. 21 Datë 30.04.2026**

## PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË Z. MUZAFER KULLA

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 54 shkronja "e", në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i përditësuar dhe në VKM-në nr.408, datë 13.05.2018 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e përditësuar, neni 6/1

**VENDOSI:**

**I.**Të miratojë kërkesën e Z. Muzafer Kulla për ndërtimin e një kasolleje me element të çmontueshëm, në respektim të kuadrit ligjor në fuqi, pranë parcelës GJ3900024, ZK: 2781 Nepravishtë.

**II.**Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimit Urban.

**III.**Ky vendim hyn në fuqi në përputhje me piken 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

**SEKRETARI I KËSHILLIT** **KRYETARI I KËSHILLIT**

**Rahim Skënderi** **Asim Banushaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Miratuar me 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Pro : 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë

Adresa: Lagjia "Linua" Libohovë, email-bashkialibohove@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I SHËRBIMIT URBAN

Nr.750/1 Prot.

Libohovë, më 23.4.2026

**RELACION**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË Z. MUZAFER KULLA**

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBOHOVË**

I nderuar Kryetar i Këshillit !

Të nderuar këshilltarë dhe pjesmarrës në këtë mbledhje !

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 54, shkronja "e", në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i përditësuar dhe në VKM-në nr.408, datë 13.05.2018 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e përditësuar, neni 6/1, paraqesim këtë relacion, i cili ka për qëllim të shtjellojë shkurtimisht arsyet pse duhet të miratohet kërkesa e Z. Muzafer Kulla, drejtuar Këshillit Bashkiak.

Referuar fakteve të parashtruara nga kërkuesi, i cili më konkretisht shprehet: "*Në muajin shkurt 2026, në lagjen "Kapsaq", fshati Nepravishtë ku unë banoj, nga ana e Bashkisë Libohovë janë kryer punime për zgjerimin e rrugës kryesore dhe rrugicave të lagjes. Nga këto punime të parashikuara për zgjerimin e rrugës kryesore rezulton se një objekt tipit kasolle në të cilen unë grumbulloj zahire për bagëtit për sezonin dimëror, pengon zbatimin e tij. Kjo kasolle, e ndërtuar prej babait tim dhe që pozicionohej pothuajse në mes të rrugës, për arsye të interesit publik, është parë e arsyeshme të prishet për t'i dhënë rrugë zbatimit të projektit. Lidhur me sa më lart, shpreh dakordësinë time për prishjen e këtij objekti, por njëkohësisht kërkoj që të më jepet miratimi për krijimin e kësaj kasolleje pranë parcelës GJ3900024, ZK: 2781; Nepravishtë, në një distancë relativisht të afërt nga banesa ime. Kam planifikuar ndërtimin e kësaj kasolleje me element të çmontueshëm, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, për të mundësuar çmontimin e saj në çdo rrethanë eventuale, nëse do ta sjellë nevoja*", propozojmë miratimin e kësaj kërkese, për arsyet si më poshtë vijon.

Adresa: Rruga "Avni Rustemi", Lagjia "Linua", Libohovë, Tel :00355881220091, bashkialibohovë@outlook.com

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në nenin neni 54, shkronja "e", sanksionohet se "Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca: e) **miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve**". Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, duke marrë në konsideratë edhe faktin se Z. Muzafer Kulla ka shfaqur dakorësinë e tij për prishjen e kasolles që ai përdor, me qëllim lejimin e punimeve që kryhen, vlerësojmë se kjo kërkesë e tij për dhënien e miratimit për krijimin e kasolles pranë parcelës GJ3900024, ZK: 2781; Nepravishtë, në një distancë relativisht të afërt nga banesa e tij, duhet të miratohet për tre arsye: Së pari pasi është në kompetencën e Këshillit Bashkiak; së dyti për faktin se ky banor ka shfaqur vullnetin për prishjen e kasolles publike për t'i dhënë përparësi interesit publik dhe së treti; sipas asaj që deklaron në kërkesën e tij kasollen e re do ta ndërtojë me materiale të çmontueshme, në përputhje me kuadrin ligjor, çka do të analizohet më poshtë.

Lidhur me sa më lart, bazuar edhe në VKM-në nr.408, datë 13.05.2018 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e përditësuar, e cila në nenin 6/1, pika pika 2 dhe 2.2 të saj përcakton se: 2) "*Në zonat rurale, pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave ligjore të parashkuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtaritë ndërtimore sipas hierarkisë territorale të parashikuar në dokumentet vendore të planifikimit, përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa u përket qëndrueshmërisë, mbrojtjes nga zjarri, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore,* ***kryhen nëpërmjet njoftimit sipas procedurave të parashikuara në nenin 6/2, të kësaj rregulloreje, pa u pajisur me leje ndërtimi****, punimet, si më poshtë: 2.2)* ***iii) struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe/ose të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, muratura e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 12-mujor nga momenti i lëshimit;*** vlerësojmë se kërkesa e Z. Muzafer Kulla është në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor.

Në interpretim të sa më lart, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak, miratimin e P/Vendimit.

Bashkëngjitur po Ju paraqesim Projekt Vendimin.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin !

**SPECIALIST I SHËRBIMIT URBAN**

**Ervin Idrizi**

Adresa: Rruga "Avni Rustemi", Lagjia "Linua", Libohovë, Tel :0035588122091, bashkialibohovë@outlook.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr.759/12 Prot.

Libohovë, më 23. 4 .2026

# PROJEKT-VENDIM

## NR.______, DATË___.___.2026

## PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË Z. MUZAFER KULLA

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 54 shkronja "e", në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i përditësuar dhe në VKM-në nr.408, datë 13.05.2018 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e përditësuar, neni 6/1

## VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Z. Muzafer Kulla për ndërtimin e një kasolleje me element të çmontueshëm, në respektim të kuadrit ligjor në fuqi, pranë parcelës GJ3900024, ZK: 2781 Nepravishtë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimit Urban.

3. Ky vendim hyn në fuqi në përputhje me pikën 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

**NËNKRYETARI**
**Xhelil Tusuni**

**KRYETARI**
**Leonard Hide**

**JURISTI**
**Kristaq Ciko**

Adresa: Rruga "Avni Rustemi", Lagjia "Linua", Libohovë, Tel :0035588122091, bashkialibohovë@outlook.com

755 Prot

BASHKIA LIBOHOVË

Datë 23.04.2026

**KËRKESË**

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBOHOVË**

**Për dijeni:** **BASHKISË LIBOHOVË**

Unë, i nënshkruari Muzafer Xhavit Kulla, banues i fshatit Nepravishtë, paraqes përpara Këshillit Bashkiak Libohovë, kërkesën lidhur me sa vijon:

Në muajin shkurt 2026, në lagjen "Kapsaq", fshati Nepravishtë ku unë banoj, nga ana e Bashkisë Libohovë janë kryer punime për zgjerimin e rrugës kryesore dhe rrugicave të lagjes. Nga këto punime të parashikuara për zgjerimin e rrugës kryesore rezulton se një objekt tipit kasolle në të cilen unë grumbulloj zahire për bagëtit për sezonin dimëror, pengon zbatimin e tij.

Kjo kasolle, e ndërtuar prej babait tim dhe që pozicionohej pothuajse në mes të rrugës, për arsye të interesit publik, është parë e arsyeshme të prishet për t'i dhënë rrugë zbatimit të projektit.

Lidhur me sa më lart, shpreh dakordësinë time për prishjen e këtij objekti, por njëkohësisht kërkoj që të më jepet miratimi për krijimin e kësaj kasolleje pranë parcelës GJ3900024, ZK: 2781; Nepravishtë, në një distancë relativisht të afërt nga banesa ime. Kam planifikuar ndërtimin e kësaj kasolleje me element të çmontueshëm, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, për të mundësuar çmontimin e saj në çdo rrethanë eventuale, nëse do ta sjellë nevoja.

Shpresoj që kërkesa ime të merret parasysh.

**KËRKUESI**

**MUZAFER KULLA**